


“Limak Kosovo International Airport” J.S.C. SH.A. Prishtinë



RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**PËR PARKUN E ENERGJISË DIELLORE ME FUQI 1.948 MW,
SLLATINË E MADHE, FUSHË KOSOVË**



Korrik, 2024

“Limak Kosovo International Airport” J.S.C. SH.A. Prishtinë



**RAPORT I
VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR PARKUN E ENERGJISË DIELORE ME FUQI 1.948 MW,
SLLATINË E MADHE, FUSHË KOSOVË**

Hartues i VNM-së:

Dr.sc. Raif Bytyçi, inxhi. i mjedisit, person fizik i licencuar

“Eko Inxhiniering” sh.p.k.
Prishtinë

Aplikon për Pëlqim Mjedisor:
Limak Kosovo International Airport J.S.C.

Korrik, 2024

Përmbajtja

1.	Hyrje	5
2.	Baza për hartimin e raportit të VNM-së	6
2.1.	Rregullativa ligjore	6
2.2.	Metodologjia e punës	8
3.	Karakteristikat e lokacionit dhe mjedisit	9
3.1.	Potencialet ekzistuese të projektit	9
3.2.	Pozita gjeografike e lokacionit, ku shtrihet projekti	10
3.3.	Popullsia dhe vendbanimet	17
3.4.	Aspektet gjeologjike	18
3.5.	Kushtet dhe karakteristikat klimatike.....	19
3.6.	Gjendja hidrologjike - ujerat	19
3.7.	Ajri	20
3.8.	Toka Karakteristikat sizmike	21
3.9.	Flora dhe fauna	22
3.10.	Infrastruktura	23
3.11.	Karakteristikat sizmike	23
3.12.	Efektet vizuale	24
3.13.	Trashëgimia kulturore dhe aspekti socio ekonomik	24
4.	Përshkrimi teknik i projektit, parku i paneleve diellore me fuqi 1.958 MW	25
4.1.	Parimi punës	25
4.1.1.	Rrezatimi solar	26
4.1.2.	Orientimi, këndi i vendosjes dhe temperatura e modulit fotovoltai	27
4.2.	Pajisjet e sistemit solar fotovoltai	28
4.2.1.	Moduli fotoliktik	28
4.2.2.	Invertori	29
4.2.3.	Kablllo	30
4.2.3.1	Kablllo solare	30
4.2.3.	Kabllot alternative	31
4.2.4.	Mbrojtja e sistemit solar fotovoltik	31
4.2.4.1	Rreziku nga zjarri	31
4.2.4.2	Mbrojtja nga mbirrymat	32
4.2.4.3	Mbrojtja nga mbirrymat në anën AC	33
4.2.4.4	Mbrojtja nga mbitensionet	33
4.2.5.	Konstruksioni	36
4.3	Projekti elektrik	37
4.3.1.	Dimenzionimi i sistemit solar fotovoltai	37
4.3.1.1	Dimenzionimi i vargut	38
4.3.2.	Llogaritjet elektrike	38
4.3.2.1	Llogaritja e seksionit dhe rënies së tensionit në kabllon e vargut	38
4.3.2.2	Llogaritja e seksionit dhe rënies së tensionit në përçues AC	39
4.3.3.	Prodhimi i energjisë	40
4.4.	Operimi dhe mirëmbajtja	41
4.4.1.	Operimi	41
4.4.2	Mirëmbajtja dhe obligimet e mirëmbajtësit	41
4.5	Plani i emergjencës	42

4.6.	Ndikimi i mjedisit në funksion te Parkut të energjisë diellore	46
4.7.	Alternativat e projektit	47
4.8.	Kosto e investimi në parkut te energjisë diellore me fuqi 1.948 MW	48
5.	Vlerësimi i ndikimeve të mundshme ne mjedis	49
5.1	Ndikimet në mjedis gjatë përgatitjeve dhe ndërtimit	49
5.1.1.	Toka	50
5.1.2	Mbeturinat	50
5.1.3.	Ajri	51
5.1.4.	Ujërat	51
5.1.5.	Zhurma	51
5.1.6.	Flora dhe fauna	52
5.2.	Ndikimet ne mjedis gjate fazës se operimit	53
5.2.1.	Ndikimi nga pajisjet që duhet instaluar	53
5.2.2.	Reflektimi i dritës	53
5.2.3.	Pasqyrimi	54
5.2.4.	Peizazhi	54
5.2.5.	Fushat elektrike dhe magnetike	54
5.2.6.	Efektet vizuale	55
5.2.7.	Ndikimet ne faunë	55
5.3.	Ndikimet ne mjedis pas ndërprerjes se shfrytëzimit	56
5.4.	Përshkrimi i pasojave të mundshme mjedisore të projektit	56
5.4.1	Rreziqet për mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga fatkeqësitë ose katastrofat	56
5.4.2.	Ndikimet e mundshme në trashëgiminë kulturore	56
6.	Masat për mbrojtje të mjedisit	57
6.1	Masa e përgjithshme gjatë ndërtimit	57
6.1.1.	Masat mbrojtëse nga zhurma dhe gazrat	57
6.1.2.	Masat e mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësore	58
6.1.3	Masat e përkujdesjes për materialin tepricë	58
6.2.	Masat e mbrojtjes se mjedisit gjate operimit	59
6.2.1.	Masat e mbrojtjes së llojeve bimore dhe shtazore	59
6.2.2.	Masat e mbrojtjes së dheut	59
6.2.3.	Masat për menaxhimin e mbeturinave	60
6.2.4.	Masat për zbutjen e ndikimeve vizuale	61
6.2.5.	Masat e mbrojtjes së zoogjeve	61
6.3.	Masat e mbrojtjes së mjedisit pas ndërprerjes së projektit	62
7.	Masat rehabilituese pas përfundimit te projektit	62
8.	Programi i monitorimit dhe raportimi	63
9	Përmbajtja jo teknike e informatave	64
9.1.	Përshkrimi i shkurtër i procesit	64
9.2.	Ndikimet ne mjedis	67
9.3.	Masat mjedisore	70
10.	Përfundim	72
	Shtojcat – dokumentacioni	73

1.HYRJE

Investitori Limak Kosovo International Airport J.S.C. Prishtinë, ka bërë përgatitjet e dokumentacionit për fillimin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun e energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë.

Raporti i VNM-së paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor, i nevojshëm për tu pajisur me leje të ndërtimit.

Me qëllim që të identifikohen dhe analizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin Parku i energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë dhe mjedis, duke i përshkruar lokacioni e projektit, përshkrimin e projektit dhe masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku do ushtrohet kjo veprimtari.

Në raportin e VNM-së duhet analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin e Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë dhe karakteristikat inxhinjeriko - teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër.

Në raportin e VNM-së do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten nga Parku i energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë dhe mjedisi, duke mos anashkaluar edhe ndikimet kumulative në regjionin më të gjerë.

Qëllim i këtij raporti mjedisore për Parkun e energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, është identifikimi i burimeve eventuale të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve negative mjedisore, konform vlerave limite të lejuara.

Gjithashtu që gjatë punës së rregullt dhe në rast të aksidenteve të mundshme të pengohen apo zvogëlohen pasojat negative në mjedis.

Me rastin e hartimit të raportit duhet marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimin e masave për zvogëlimin e ndikimeve në mjedise, gjatë fazës së ndërtimit, gjatë realizim-it të aktiviteteve në Parkun e energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë.

Pra me këtë raport mjedisor do të ofrohen informata të mjaftueshme për zonën ku shtrihet projekti, procesin, ndikimet e tij në mjedisin e afërt dhe zonën më të gjerë, si dhe masat mjedisore që ndërmerren gjatë zhvillimit të aktiviteteve të këtij projekti dhe ndikimeve eventuale që do të mbetnin pas.

2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

VNM është hartuar në bazë të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 (2023), i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinual i Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, dhe atë:

- identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimeve në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimit mjedisor gjer në kufijtë e lejuar.

Raporti i VNM-së përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti ambiental.

2.1. Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të Raportit të VNM -së për Parkun e energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të aplikuara që do të shënohen me poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023)
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022)
- Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11

- Ligji për kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë
- Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor
- Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ Nr.13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ MMPH, Nr.10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës
- Udhëzimi administrativ Nr.05/13. për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturine.

b) Dokumentacioni teknik

- Projekti teknik për Parkun e energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatine Madhe, Fushë Kosovë, më objektet infrastrukturën përcjellëse
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Certifikata mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit të ngastrës
- Plani i situacionit etj.
- Pëlqimin e komunës ose njoftim - informatë sipas PZHK.

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse si që është direktiva e VNM-së (85/337/EEC).

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për Parkun e energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë:

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin e Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë,
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë të materies ndotëse.

c) Analiza e rrezikimit të

- njeriut
- vlerave materiale
- vlerave natyrore.

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin e projektit.

Pjesë e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet vlerësimin të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik.

Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3. KARAKTERISTIKAT E LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit ku pritet të ndërtohet Parku i energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, janë bazë themelore për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke e shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren dhe në bazë të vizitës studimore të lokacionit.

Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçe të hulumtimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku do të ndërtohet Parku i energjisë diellore "me fuqi 1.945 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë.

Me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siç janë: toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna.

Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit.

Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është relevant në vlerësimin real të gjendjes mjedisore.

Faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit mjedisore të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë.

3.2. Pozita gjeografike e lokacionit, ku shtrihet projekti

Lokacioni ku do të ndërtohet Parku i energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë.

Ky lokacion, toka është ne pronësisë se Aeroportit te Prishtinës, që i takon Komunës se Fushë Kosovës, hapësira te lira ne periferi, përkatësisht ne veri te zonës se Aeroportit.

Zona e lokacionit ku shtrihet projekti është më shumë rendësi të ketë investime të kësaj natyre, si mundësi për tu kthyer me një lloje aktiviteti qe gjenerone energji nga burimet e ripërtriteshme, përkatësisht pa djegie te fosileve, rrjedhimisht pa shkaktuar ndotje te larte ne mjedisin jetësorë.

Zona e projektit ka qasje të mirë në infrastrukturën rrugore, dhe infrastrukturën tjetër përcjellës, në rrymë, ujë dhe infrastrukturën tjetër përcjellës të nevojshme për nevoja të projektit.

Pozita gjeografike me elementet tjera (duke qene zone e Aeroportit ne vend), bëjnë që kjo zonë të jetë shume e frekuentuar. Në vijim paraqitja hartografike e zonës së gjerë të lokacionit të projektit, figura 1.




Figura 1. Paraqitja hartografike e lokacionit ku shtrihet projekti, zona e gjerë

Përshkrimi i lokacionit të ngushtë - Parku i energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë.

Me kërkesë të investitorit Limak Kosovo International Airport J.S.C. Prishtinë për qëllime të projektit të ndërtimit të Parkut të energjisë diellore “me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, është pajisur me Pëlqim nga Komuna e Fushë Kosovës (Pëlqimi Komunal dhe Certifikata e pronësisë, bashkangjitur ne shtojce te VNM-se).

Lokacioni i parkut te energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë:

- Zyra kadastrale Fushë Kosove,
- Zonat kadastrale Sllatinë e Madhe, vendi i quajtur Glozhnja
- Nr. i ngastrave:
 - P - 72514009-01018-2, me sipërfaqe 4501 m²
 - P - 72514009-01022-1, me sipërfaqe 14639 m²
 - P - 72514009-01019-1, me sipërfaqe 11366 m²
 - P - 72514009-01020-0, me sipërfaqe 16797 m²
 - P - 72514009-01005-0, me sipërfaqe 18603 m²
 - P - 72514009-01006-0, me sipërfaqe 9122 m²
 - P - 72514009-01007-1, me sipërfaqe 8391 m²
 - P - 72514009-01008-2, me sipërfaqe 4063 m²
 - P - 72514009-01003-1, me sipërfaqe 4314 m²
 - P - 72514009-01042-22. me sipërfaqe 1232 m²



Figura 2. Paraqitja hartografike e lokacionit ku shtrihet projekti – zona e ngushte

Projekti i Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Zyra kadastrale Fushë Kosove, Zona kadastrale Sllatinë e Madhe, vendi i quajtur Glozhnja, figura 3, në vijim – vendosja e paneleve diellore.




Figura 3. Baza gjeodezike e lokacionit, Parku i energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë

Zona e lokacionit, ku shtrihet projekti Parku i energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Zyra kadastrale Fushë Kosove, Zonat kadastrale Sllatinë e Madhe, vendi i quajtur Glozhnja, është ne periferi te Aeroportit te Prishtinës, ne anën veriore, me vendbanime në rrethine, e në distancë të konsiderueshme në një perimetër me shume se 1 kilometër (si në përshkrimet ne vijim). Vendbanimet me te afërta janë fshati Sllatina e Madhe ne veri dhe fshati Henc në lindje të lokacionit të projektit, gjenden në një distancë rreth rreth 1 km dhe të tjerat objekte ne distance më të afërt (rreth gjysmë km, por që shërbejnë për qëllime biznesore, në vijim pamje të lokacionit.



*Figura 4. Lokacioni i projektit Parku i energjisë diellore me fuqi 1.948 MW,
Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë*

Në veri - të lokacionit të *projektit Parku i energjisë diellore* me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, parcela kufizohet me hapësirë të lirë, tokë në pronësi të Aeroportit në distance rreth 280 m, përtej saj graviton hekurudha në shërbim të minierës së Ferronikelit, që gjendet në perëndim të lokacionit.

Përtej hekurudhës, hapësirë e lirë (tokë pune) dhe përtej saj gjenden disa objekte afariste përgjatë rrugës së Aeroportit dhe rruga magjistrale Prishtinë – Komaran, në distance rreth 1km. Pamjet në veri të lokacionit të projektit, figurën 5, në vijim.



Figura 5. Lokacioni i projektit (rruga) në veri të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë

Në lindje - ku shtrihet projekti parcela kufizohet me hapësirë të lirë, tokë pune në pronësi të Aeroportit. Ne distance rreth 1.15 km gjendet fshati Hencë, dhe paksa ne lindje jug fshati Radeve, ne distance rreth 1.5 km. Ne këtë zone gjendet edhe liqeni i quajtur “Ligatina”.

Pra liqeni “Ligatina” ndodhet ne drejtim te fshatit Henc, përkatësisht Radavc, ne distance nga lokacioni i projektit rreth 1.7 deri 2 km. Ne këtë Ligatine gjenden zogjtë te cilën paraqesin vlera te mbrojtura te llojit te tyre përkatësisht faunës se kësaj zone. Duhet shtuar se ne zonën e projektit (ne menaxhim te Aeroportit) funksionin ekipi profesional për largimin e zoogjeve nga fluturimi ne këto hapësira (për funksion te fluturimit te Aeroplanëve) dhe kjo njëkohësisht do te shërbej edhe ne funksion te aktivitetit te paneleve diellore. Ne vijim pamjet ne lindje te lokacionit te projektit, figura 6.



Figura 6. Lokacioni i projektit (rruga) në lindje të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë

Në jug - ku shtrihet projekti kufi me parcelën graviton trupi ujore përroska që vjen nga ana perëndimorë dhe lëvizë përgjatë parcelës, drejt lindjes. Panelet diellore vendosen ne distance rreth 50 metra nga përroska, pasi qe kemi hapësire të mjaftueshme dhe kjo mundëson qe të mos ketë ndikime në mes të Projektit te paneleve diellorë dhe përroskës së ujerave.

Përtej parcelës kemi tokë ne pronësi te Aeroportit, ku gjenden edhe disa objekte ne shërbim te Aeroportit ne distance rreth 230m (ne përjashtim te një objekti hotelier ne distance me shume se rreth 250m, prone private) e gjithë hapësira përreth dhe objekte përtej kësaj distance janë në pronësi dhe në funksion të Aeroportit të Prishtinës. Në vijim pamjet në jug të lokacionit të projektit, figura 7.



Figura 7. Lokacioni i projektit (rruga) në jug të Parkut të energjisë diellore më fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë

Në perëndim - ku shtrihet projekti i Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.945 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, përgjatë parcelës graviton rruga e Aeroportit, përtej saj parcela e kufizohet me hapësirë të lirë, kryesisht ara të tipit kullosa druje, shkurre te rralla. Ne veriperëndim te kësaj ane gjendet vendbanimi më i afërte fshati Sllatine e Madhe në distance rreth 1km dhe andej graviton dhe rruga magjistrale Prishtine – Komaran që lidhë këto hapësira me Rrafshin e Dukagjinit dhe rrugën e Kombit përkatësisht Kosovën me Shqipërinë. Ne perëndim të lokacionit gjendet fshati Harilaq në distance rreth 2 km dhe përtej sajë dhe bjehket e Goleshit. Figura 8, në vijim, pamjet në perëndim të lokacionit të projektit.



Figura 8. Lokacioni i projektit (rruga) në perëndim të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë

3.3. Popullsia dhe vendbanimet

Njërën nga aspektet e rëndësishme të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar.

Sipas të dhënave ekzistuese, sipas të regjistrimit të vitit 1981 në territorin e komunës së Fushë Kosovës kanë jetuar 29.804 banorë. Sipas shënimeve jo të konfirmuara, të prezantuara në Planin Zhvillimor Urban të Fushë Kosovës Komuna e Fushë Kosovës kishte rreth 35050 banorë. Regjistrimi i fundit nga ESK (2011) tregon se në Komunën e Fushë Kosovës numri i regjistruar i banorëve është 34718. Ndërkaq sipas vlerësimit të Komunës së Fushë Kosovës numri i banorëve në këtë komunë është 55000 dhe ky numër tani duhet të jete me i madhe dhe është ne rritje te shpejte, kjo nga lëvizjet e popullsisë nga komuna tjera drejt Fushe Kosovës.

Komuna e Fushë Kosovës zë pozitën qendrore të Rrafshit të Kosovës. Shtrihet në perëndim të qendrës të Kosovës - Prishtinës, rreth 4-5 km, larg saj, apo më mirë të themi, tani është bashkuar me të. Kufizohet në lindje me komunën e Prishtinës, në jug me komunën e Lipjanit, në perëndim me komunën e Drenasit dhe në veri me komunën e Kastriotit. Fushë Kosova është nyja kryesore e komunikacionit hekurudhor të Kosovës. Nga qendra komunale degëzohen rrugët hekurudhore për në Mitrovicë e më tutje në veri, për në Shkup e më tutje në jug, në verilindje për në Prishtinë, trevën e Llapit e më tutje në verilindje me Nishin, në perëndim për në Pejë dhe në jugperëndim në Prizren. Tani kjo komunë është edhe qendër e komunikacionit ajror. Në fshatin Sllatinë e Madhe që nga viti 1965 është hapur Aeroporti i Prishtinës.

Në strukturën demografike të komunës së Fushë Kosovës përpos dyndjeve natyrale dhe ekonomike kanë luajtur një rol të madhe dhe vendosja e popullatës për shkaqe të tjera si kolonizimi serb rreth 396 familje dhe vendosja e popullsisë refugjate nga Toplica e pjesë tjera të perandorisë Osmane si Sanxhaku i Tregut Ri dhe Bosnja.

3.4. Aspekti gjeologjik

Komuna e Fushë Kosovës në aspektin gjeologjik i takon pjesës qendrore të rrethit lindor të basenit qymyror të Kosovës. Baseni është i formuar në shkëmbinjtë të vjetërsisë-neogjen me shpërndarje të gjere të serisë së qymyrit. Në bazë të kësaj serie neogjene në mënyrë të qartë bëhet ndarja e bazës, shtresa e qymyrit dhe fundërrina.

Në sajë të bazës mund të veçohen dy horizonte litologjike. Horizonti i poshtëm përbëhet nga rëra ndërsa ai i sipërm nga rëra argjilore ngjyrë hiri në të gjelbër. Shtresa e thëngjillit përbëhet prej linjiteve me shtresa të holla të djerrinës. Shtresa fundrrinore përbëhet nga argjila ngjyrë hiri me grimca vende-vende të gëlqeres. Në pjesë të caktuara të terrenit shtresa fundërrinore) përmbi shtresën e thëngjillit shtrihet direkt në formimet aluviale.

Pjesët sipërfaqësore të terrenit i krijojnë shtresat aluviale. Formësimet aluviale janë të përbëra me argjilë ranoro-pluhurore, me rërë kokërrimët dhe vende-vende me përmbajtje më të madhe të fraksioneve të zhavorrit.

3.5. Kushtet dhe karakteristikat klimatike

Komuna e Fushë Kosovës ndodhet ne Basenin e Kosovës, i cili është ne fushën e Ibrit ne veri dhe ne fushën e Llapit - Toplices, ne veri-lindje, i hapur ndaj ndikimeve veriore - kontinentale - klimatike. Dimri është i ftohte, ndërsa vera është e ngrohte dhe e thate. Baseni i Kosovës, për shkak te kufizimeve me male te larta ne jug dhe perëndim janë te privuar nga masat ajrore te Detit Adriatik dhe Detit Egje. Ne rajonin e Komunës se Fushe-Kosovës janë përpunuar te dhënat meteorologjike për dy stacione.

Lartësia mbidetare e stacioneve te përpunimit është: Prishtine 573m, Lismir 540m. Rajoni i analizuar është homogjen orografik, lartësia mbidetare e territorit është ne intervalin prej 500 - 600m. Parametrat meteorologjike qe varen nga lartësia mbidetare janë: temperatura e mesme vjetore e ajrit bie me rritjen a lartësisë mbidetare, ndërsa sasia e te reshurave vjetore rritet. Numri i deteve vjetore me bore, si dhe numri i ditëve me shtrese te bores rritet varësisht nga lartësia mbidetare, ndërsa parametrat tjerë meteorologjike varen nga kushtet lokale mikroklimatike.

Temperatura e ajrit - temperatura e mesme vjetore e ajrit ne rajonin e hulumtuar është 9,7°C, muaji me i ftohte është janari, me temperature mesatare të ajrit rreth 1,0°C, korriku është më i ngrohti, me temperature 19,3°C. Muaji tetor është me i ngrohte se prilli.

Era - Është e kushtëzuar nga faktorët e ndryshëm, kështu qe dendësia e drejtimeve te përshkuara dhe shpejtësia kane karakter lokal te kushtëzuar nga karakteri orografik i vendit. Era me e shpeshte është ajo verilindore, kurse shpejtësinë mesatare me te madhe e ka era veri-verilindore 3.7 m/s. Lagështia relative e ajrit - Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është ne intervalin prej 71,4 %, maksimumi është ne dhjetor 84 %, ndërsa mesatarja minimale ne korrik 63 %.

Vlera mesatare vjetore e shtypjes se avullit te ujit është 9,5 mb, maksimumi është ne korrik 14,4 mb, ndërsa minimumi është ne janar 5,0 mb.

Te reshurat - Shuma mesatare vjetore e te reshurave ne rajon sillet prej 620,6mm deri ne 617,4mm. Lartësia e te reshurave mujore maksimale mesatare është ne maj dhe qershor, maksimumi sekondar është ne nëntor, ndërsa minimumi me se shpeshti është ne muajin mars.

3.6.Gjendja hidrologjike - ujërat

Në territorin e kësaj komune kalon lumi Sitnica, ku në fshatin Livragonë derdhen në të, Lumi Drenica dhe Gracanka, kurse afër fshatit Kuzmin - Prishtevka. Këta lumenj janë elemente të rëndësishme të fizionomisë së peizazhit të territorit të Fushë Kosovës.

Resurset kryesore të ujërave sipërfaqësore ne komunën e Fushë Kosovës janë lumenjtë Sitnica, Drenica, Graçanka dhe Prishtina. Këta lumenjtë degëzohen në territorin e kësaj komune.

Disa nga përroskat më të rëndësishme që rrjedhin në këtë komunë janë Gjellbazaku dhe Zanoga. Sitnica është nder lumenjtë me të njohur në Kosovë dhe është dega kryesore e lumit Ibër. Ky lum dallohet nga të tjerët jo vetëm për shkak të madhësisë së pellgut (2.861 km²), por gjithashtu për shkak të rrjedhës ujore (rreth 16.5 m³/s).

Sitnica formohet nga rrjedha Matica me Sazlinë dhe lumi i Shtimes. Këto rrjedha afër fshatit Robovc bashkohen, duke formuar lumin Sitnicë. Nga këtu e deri në vend derdhje në lumin Ibër, afër Mitrovicës rrjedh për afër 90 km. Karakteristika kryesore e këtij lumi është pjerrtësia e ulët. Për këtë edhe kategorizohet si lum fushor. Sitnica dallohet jo vetëm për shkak të rrjedhës së ulët të ujit por edhe për ndryshime të theksuara gjatë vitit. Rrjedhat ujqorë janë më të larta gjatë stinës së dimrit dhe pranverës, ndërsa gjatë stinës së verës rrjedha e ujit është mjaft e ulët. Në pikën e derdhjes në lumin Ibër rrjedha e ujit bie deri në 2.35 m/s. Shtrati i lumit Sitnicë nuk është edhe aq stabil. Gjatë vërshimeve, uji nganjëherë mbulon një pjesë të madhe të fushave në pjesën e rrafshet në mes të Lipjanit dhe Mitrovicës, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme.

Sitnica i mbledh ujërat e lumenjve Gadime, Janjevë, Graçankë, Prishtinë, Llap dhe Samadrezhë në anën e djathtë, dhe ato të lumenjëve Drenicë dhe Lushtë në anën e majtë.

Në Territorin e Fushë Kosovës është i vendosur edhe një stacion hidrometrik që i takon rrjetit hidrometrik të Kosovës me 22 stacione matëse, të vendosura nga Instituti Hidrometrologjik i Kosovës. Të dhënat nga ky stacion i cili është vendosur në lokacionin Nadakoc – Vragoli tregojnë se sasia maksimale e rrjedhës është 328 m³/s ndërsa ajo minimale 0/50 m³/s.

3.7. Ajri

Ajri është element i rëndësishëm i mjedisit dhe domosdoshmëri për jetën. Ndotja e tij nga përzierja me substanca që futen në rrugë natyrore apo artificiale (burime antropogjenë), përbën shkakun kryesor të përkeqësimit të cilësisë së tij, i cili shkakton një sërë sëmundjesh humane dhe degradimin e elementeve të tjera të mjedisit. Transporti është njëri ndër ndotësit kryesor të ajrit, ujit, dhe tokës. Pasojat tjera janë zhurma urbane, dridhjet, ndërrimi i klimës, varfëria e biodiversitetit, ndryshimi i pamjes së hapësirës dhe shumë ndodhi të jashtëzakonshme (fatkeqësi të ndryshme). Kjo ka të bëjë me hapësirat urbane, posaçërisht në qytetet e mëdha dhe në hapësirat jashtë tyre. Në këtë aspekt shkaktari kryesor është transporti automobilistik, për shkak se për punën e tyre përdoren lëndët djegëse fosile. Në anën tjetër, ndotës i ajrit i rëndësishëm është përdorimi i druve dhe thëngjillit për ngrohje dhe burim energjetik.

Në hapësirat ku objekte banimi janë shtëpitë individuale dhe ngrohja është individuale, emetimi i tymit është i lartë dhe në sezonin e dimrit kur shoqërohet me mjegull është tejet i rrezikshëm, ngase në situata të tilla nuk ka erë që do ta shpërndante. Njëri ndër problemet kryesore që paraqitet si pasojë e ndotjes nga transporti është emisioni i lartë i gazrave nga lëndët djegëse të

automjeteve si: CO₂, NO_x, SO₂, CO₂. Emisionet nga automjetet shkaktajnë pjesën më të madhe të ndotjes me metalet e rënda si: Pb, etj. Gjendja mjedisore në Kosovë nuk është e mire, e shikuar nga aspekti i përgjithshëm, mirëpo komuna e Fushe Kosovës ballafaqohet me këtë problem edhe me shume. Shkaktarët që bëjnë ndotje të mjedisit dhe të ajrit janë: komunikacioni në zonën urbane, mbeturinat komunale, pluhuri, zhurma etj.

Burim kryesor i ndotjes së ajrit është Korporata Energjetike e Kosovës. Ajri nga Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, ndotet përmes tymtarëve, minierave të qymyrit dhe deponive të hirit. Gjithashtu ndotja në ditët me erë gjatë stinëve të vitit është e vazhdueshme, ku edhe përhapja e ndotjes varet nga shpejtësia dhe drejtimi i erës.

Nga KEK-u, me përmasa më të vogla, ajri ndotet edhe nga hiri i nga djekgia e qymyrit, deponite perkatese. Përveç deponive të hirit dhe tymtarëve, në ndotjen e ajrit në këtë aglomeracion ndikojnë edhe: vatrat e zjarreve në mihjet sipërfaqësore, ngrohtoret e operatorëve ekonomik, gjeneratorët e operatorëve ekonomik me kapacitete të ndryshme, emisionet nga amvisëritë, depozitat e fenolëve etj. Numri më i madh i ngrohtoreve dhe gjeneratorëve si lëndë djegëse e përdorin naftën. Gjithashtu edhe pompat dhe rezervuarët e derivateve të naftës paraqiten si rrezik për ndotjen e ajrit, sidomos në rast të aksidenteve.

3.8. Toka

Në rajonin e Komunës së Fushë-Kosovës veçohet tipi i dheut aluvial. Fluvisoli (aluviumi) bënë pjesë në klasën e dherave fluviatile dhe fluviogleje. Gjeneza e fluvisolit dhe veçoritë e saj janë të kushtëzuara me drejtimin hidrologjik të lumit dhe materialit natyror, i cili sedimentohet (rëra, zhavorri). Për këtë arsye, profili i fluvisolit karakterizohet me shtresim të theksuar.

Pa marrë parasysh që fluvisoli i takon dherave të pazhvilluara, ato zakonisht kanë plleshmëri të madhe. Në këtë tokë mund të kultivohet plepi, si dhe perimet. Janë dhera të përshtatshme për livadhe. Kjo tokë renditet në klasën e III-të të bonitetit.

Ndër tipat pedologjike të tokave të cilat janë më të përfaqësuara në Komunën e Fushë-Kosovës janë: Vertisol (smonicë), rreth 35 %, Fluvisol (aluviale), rreth 27 %, Kambike (tokat e kuqe kafeje), rreth 25 %. Vertisol (smonicë) Sipërfaqet e tokës bujqësore që bëjnë pjesë në këtë tip të tokave kryesisht shtrihen në fshatrat: Bardh, Lismir, Kuzmin, Vragoli, Miradi e Poshtme dhe Henc. Sipërfaqet e tokës bujqësore që bëjnë pjesë në këtë tip të tokave, kryesisht shtrihen në fshatrat: Nakër, Lismir, Kuzmin, Vragoli, Bardh i Vogël, Bardh i Madh, Miradi e Poshtme dhe në qytetin e Fushë-Kosovës.

Vlera mesatare e reaksionit aktiv të tokës (pH në H₂O) mesatarisht është 7.5pH, por ajo luhetet në mes pH 6.7 -7.8. Sipërfaqet e tokës bujqësore që bëjnë pjesë në këtë tip të tokës janë ato të fshatrave: Gurshkabë, Bardh i Madh, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël. Vlerat e reaksionit aktiv

të tokës (pH në H₂O) mesatarisht është 7.06 pH, me luhatje nga pH 4.6 deri 8.4 Tokat i takojnë klasës së tokave argjilore, lymore-ranore-argjilore, lymore-pluhurore-argjilore dhe lymore-argjilore.

3.9. Flora dhe fauna

Bujqësia me degët e saj mbetet akoma ndër burimet e rëndësishme të aktivitetit ekonomik të Komunës. Pjesa më e madhe e territorit të Komunës është toke bujqësore (60 %), që vështrohet nga aspekti i shfrytëzimit të hapësirës, paraqet një potencial jashtëzakonisht të madh të zhvillimit të bujqësisë, e cila mund të jetë në funksion të rritjes së punësimit dhe burimit të jetesës për popullatën që jeton në ambientet rurale. Edhe në të kaluarën, Fushë-Kosova ka qenë e njohur për zhvillimin e bujqësisë dhe për ndërlidhjen e saj me industrinë për përpunimin e prodhimeve bujqësore (drithërave, qumështit dhe mishit). Sipërfaqja e gjithmbarshme e tokave pyjore të Komunës së Fushë-Kosovës është rreth 1600 ha. Nga këto: pyje - 1619 ha, sipërfaqe të zhveshura - 1100 ha. Nga kjo sipërfaqe e mbuluar me pyje të ngritura artificialisht (kultura) janë mbi 900 ha të llojeve: pishë e bardhë, pishë e zezë, hormoq, bredh, larq, dugllazion etj.

Një pjesë e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës është e mbuluar nga malet. Malet luajnë një rol të rëndësishëm për florën dhe faunën në Komunë, si dhe për klimën globale edhe lokale, por gjithashtu edhe për ekonominë lokale. Për ta siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve, prerjet që janë bërë në të kaluarën, duhet të ripyllëzohen me fidanë që rriten në këto anë. Kështu, sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm i maleve.

Gjendja e pyjeve të Komunës së Fushë-Kosovës është e mirë dhe nuk janë sulmuar nga ndonjë agjent patogjen, apo dëmtues tjetër. Gjatë periudhave të nxehta verore kemi paraqitjen e djegieve të pyjeve, të cilat shkaktojnë dëmtime të konsiderueshme të tyre. Nga regjistrimet e rregullta të terreneve pothuaj se për çdo vit në mënyrë ilegale prehen rreth 1.000m³ dhe afro 2.000m³ në mënyrë legale nga prerjet e rregullta, si dhe nga pastrimet sanitare të pyjeve.

Zonat e mbrojtura në Fushë-Kosovë:

Emri i objektit: Bima endemike Forsythia Europea-Boshtra; Viti i shpalljes: 2005; Kategoria mbrojtëse: Zonë me vlera të veçanta natyrore;

Emri i objektit: Kalaja e Harilaçit dhe Bardhit të Madh; Viti i shpalljes: 2007; Kategoria mbrojtëse: Zona turistike-natyrore.

Fauna në Komunën e Fushë Kosovës është tipike për Kosovë, me kafshe shtëpiake që mbahen edhe në vise të tjera, gjithashtu karakterizohet me prezencën e shpendëve shtëptar, si lejleku që ndërton shtrofullat interesante dhe atraktive (fshatrat Henc, Miradi e Poshtme, Miradi e Epërme, Harilaç dhe rreth liqenit të "Hencit").

Specifike e këtij regjioni është *Ligatina* (ne drejtim te fshatit Henc, përkatësisht fshati Radavc), ne distance nga lokacioni i projektit rreth 1.7 deri 2 km. Ne këtë Ligatine gjenden zogjtë te cilën paraqesin vlera te mbrojtura te llojit te tyre përkatësisht faunës se kësaj zone. Duhet shtuar se ne zonën e projektit (nen menaxhim te Aeroportit) funksionin ekipi profesional “WIRDLIFE” për largimin e shpendëve nga fluturimi në këto hapësira (për funksion të fluturimit të Aeroplanëve) dhe kjo njëkohësisht do të shërbej edhe në funksion të aktivitetit të paneleve diellore.

3.10. Infrastruktura

Infrastruktura është bazë për çdo zhvillim, parakusht për ngritjen e bizneseve por po ashtu edhe për ngritjen e mirëqenies sociale. Shtrirja e infrastrukturës njëkohësisht përcakton edhe shtrirjen e ndërtimeve dhe zhvillimit ekonomik.

Për përmirësimin e kushteve ekzistuese të rrjetit infrastrukturor në komunë dhe para prirjen e zhvillimit ekonomik e social të paraparë me Planin Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës janë përcaktuar këto caqe prioritare për ngritjen e infrastrukturës në komunë:

- Ndërtimi i rrugëve të reja si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese në rrjetin komunal të trafikut automobilistik e hekurudhor
- Përmirësimi i lidhjeve të transportit publik në tërë komunën, me fokus të veçantë në vijën Aeroport - Fushë Kosovë – Prishtinë, referim “projekti” për Prishtinën Metropolitane, në koordinim me KK Prishtinë
- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit
- Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe shtimi i kapaciteteve prodhuese te ujit
- Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike dhe rrjetit të telefonisë e internetit.
- Ndërtimi i rrugëve të reja si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese në rrjetin e komunikacionit në komunën e Fushë Kosovës.

Sistemi efikas i rrjetit rrugor është bazë për krijimin e mundësive për qarkullim të lehtë dhe të sigurt, nxitjen e zhvillimit ekonomik, krijimin e lidhjeve në mes të zonave dhe përmbajtjeve funksionale të Komunës së Fushë Kosovës.

3.11. Karakteristikat sizmike

Sizmika mikro - regjionale e këtij lokacioni dallohet me mundësi të dridhjeve të tokës të intensitetit prej rreth 6.5 shkallë të Merkalit. Sipas hartave sizmike të regjionit, hapësira e gjerë te hulumtuar nuk i përket një intensiteti të njëjtë të dridhjeve sepse varet nga karakteristikat gjeologjike të tokës, thellësisë së ujërave nëntokësore etj.

3.12. Efektet vizuale

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin projekti i energjisë diellore - mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Sipas projektit të planifikuar ndërtimi i Parku i energjisë diellore, nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, sepse ky projekt nuk paraqet objekte të mëdha e të papranueshme për syrin e njeriut. Përkundrazi ky projekt mund të zhvillohet në harmoni me natyrë, nuk ndikon shumë në shikuesin, dhe mjedisin pa trajtuara si dhe hedhja e mbeturinave në shtratin e lumit dhe përskaaj tij.

3.13. Trashëgimia kulturore dhe aspekti socio ekonomik

Gjetjet arkeologjike në Komunën e Fushë-Kosovë (Kalanë e Harilaqit dhe Bardh) mbështesin përfundimin se ky lokalitet është një nga zonat e vjetra të qytetërimit parahistorik në Ballkan. Në komunën e Fushë Kosovës gjenden disa objekte dhe lokalitete të trashëgimisë kulturore:

- Lokaliteti arkeologjik në Harilaq,
- Lokaliteti në Bardh të Madh, Objektet tjera kulturore përbëjnë:
- Monumenti i “Imer Sfarqa”;
- Monumenti i “ Hashim Hajdini “
- Pllaka e “Nëna Terezës”.

Zhvillimi i trashëgimisë kulturore - parashihet në kuadër të projekteve: Konsolidimi i turizmit në komunë, funksionalizimi i pikave dhe zonës me potencial turistik në përfundim të komunës, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore si dhe promovimi i turizmit në këto dy fusha mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë natyrore.

Gjendja sociale - është në proces të vazhdueshëm të përmirësimit dhe ndryshimit në përgjithësi. Kjo varet nga zhvillimi i shumë faktorëve të cilët po ashtu janë variabilë.

Zhvillimi social varet prej tre sektorëve bazë të zhvillimit social të cilët ndryshojnë në funksion me ndryshimin e nevojave njerëzore dhe ata janë:

Shëndetësia- jetë e gjatë dhe e shëndoshë për banorët,

Arsimi- marrja e aftësive, njohurive profesionale dhe të përgjithshme, dhe - qasja në burimet private dhe publike, të nevojshme për një jetë të mirë.

4.PËRSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT PARKU I ENERGJISË DIELLORE ME FUQI 1.948 MW, SLLATINË E MADHE, FUSHË KOSOVË

Sistemi solar fotovoltaik shndërron energjinë e dritës së diellit në energji elektrike. Ky shndërrim kryhet pa konsumuar lëndë djegëse fosile, pa krijuar ndotje dhe zgjatë për dekada me një kosto minimale të mirëmbajtjes. Përdorimi i një burimi të bollshëm dhe të sigurve të energjisë siç është dielli e bën këtë teknologji lehtë të aplikueshme.

Përparësitë kryesore të një sistemi solar fotovoltaik janë: prodhimi i shpërndarë i energjisë, nuk ka emetim të materialeve ndotëse, kursimi i lëndëve djegëse, dhe jetëgjatësia si pasojë e punës në qetësi e pajisjeve përbërëse.

Intensiteti i prodhimit të energjisë varet drejtpërdrejtë nga ndryshueshmëria e pozitës së diellit gjatë ditës dhe vitit.

Energjia vjetore që prodhohet nga një sistem solar fotovoltaik varet nga faktorë të ndryshëm, ndër ta: këndi i rezeve të diellit në vendin ku planifikohet instalimi i sistemit, orientimi dhe këndi i vendosjes së moduleve fotovoltaike, prezenca ose jo e hijeve, performanca teknike e pjesëve përbërëse të sistemit. Sistemi solar fotovoltaik varësisht nga funksioni mund të jetë i kyçur në rrjet apo i shkyçur nga rrjeti.

Pjesët përbërëse të këtij lloji të sistemit solar fotovoltaik janë: modulet fotovoltaike, konstruksioni mbajtës, invertori, kuadrot mbrojtëse nga ana DC dhe AC, përçuesit solar, përçuesit alternativ, dhe tabelat shpërndarëse elektrike.

Sistemet solare fotovoltaike të kyçura në rrjet shërbejnë për të zvogëluar shpenzimin e energjisë elektrike që tërhiqet nga rrjeti. Gjatë kohës sa ka rrezatim të diellit sistemi solar fotovoltaik prodhon energji. Kjo energji e prodhuar përdoret për të përmbushur kërkesën për energji të konsumatorit dhe për zvogëlimin e faturave të energjisë elektrike nga KEDS.

4.1.Parimi punës

Nisur nga pikëpamja energjetike, parimi kryesor sipas së cilit dizajnohet një sistem solar fotovoltaik është arritja e një ekspozimi sa më të lartë ndaj rrezatimit solar në mënyrë që të ketë prodhim sa më të lartë të energjisë. Faktorët kryesorë që ndikojnë në prodhimin e energjisë nga sistemi solar fotovoltaik janë: niveli i rrezatimit solar, orientimi, këndi i vendosjes, temperatura e moduleve fotovoltaike, dhe efienca e sistemit si tërësi.

4.1.1. Rrezatimi solar

Me rrezatim diellor nënkuptohet intensiteti i rrezatimit elektromagnetik në sipërfaqe prej një metër katror $\left[\frac{kW}{m^2}\right]$. Vlerat për prodhimin mesatar solar për kWp dhe diellosjen në Kosovë mund të merren nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës¹ dhe Sistemi informues gjeografik për fotovoltaike në kuadër të Komisionit Evropian².

Të dhënat mbi prodhimin mesatar solar për 1 kWp mund të dallojnë varësisht nga burimi i të dhënave, për arsye se nxjerrën nga procesimi statistikor i të dhënave të grumbulluara në intervale të ndryshme kohore.

Këto të dhëna varen nga ndryshimi i kushteve të motit prej një viti në vit tjetër. Si pasojë, të dhënat e diellosjes kanë kuptim probabilistik. Kjo nënkupton se paraqesin vlera të cilat priten të jenë, e jo saktësi definitive. Për të gjetur energjinë e cila pritët të prodhohet nga K kWp bëjmë llogaritjen sipas formulave të mëposhtme.

$$E_p = K \cdot E_{rrmv} \cdot \eta_{BS} \left[\frac{kWh}{kWp} \right]$$

Ku,

E_p – Energjia që pritët të prodhohet

K – Kapaciteti i sistemit solar të propozuar në kWp

E_{rrmv} – Rrezatimi mesatar vjetor

η_{BS} – Eficienca e përgjithshme e të gjitha pajisjeve të sistemit

Ose,

$$E_p = K \cdot E_{rrmd} \cdot 365 \cdot \eta_{BS} \left[\frac{kWh}{kWp} \right]$$

Ku,

E_p – Energjia që pritët të prodhohet nga K kWp

K – Kapaciteti i sistemit solar të propozuar në kWp

E_{rrmd} – Rrezatimi mesatar ditor

η_{BS} – Eficienca e përgjithshme e të gjitha pajisjeve të sistemit

¹ Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës - <http://ihmk-rks.net/>

² PVGIS - https://re.jrc.ec.europa.eu/pvg_tools/en/tools.html

4.1.2.Orientimi, këndi i vendosjes dhe temperatura e modulit fotovoltaik

Eficienca më e lartë e një moduli fotovoltaik do të arrihej nëse këndi i rënies së rrezeve të diellit do të ishte gjithmonë 90°. Këndi i rënies së rrezeve të diellit varet nga deklinacioni solar dhe gjerësia gjeografike e vend ndodhjes së modulit fotovoltaik.

Sipas IEC/TS 61836 është e mundshme të gjindet një kënd β i vendosjes së moduleve fotovoltaike me rrafshin horizontal ashtu që rrezet e diellit të kenë kënd të drejtë në mesditën e ditës më të gjatë të vitit. Për të arritur prodhimin më të lartë, merret parasysh rruga në të cilën kalon Dielli gjatë periudhave të ndryshme të vitit. Për hemisferën veriore, modulet fotovoltaike duhet të orientohen sa më në jug që është e mundshme. Kështu, kalkullohet këndi për të cilin rrezatimi total vjetor është më i lartë se sa nën kushtet kur rrezet e diellit kanë kënd të drejtë gjatë solsticit veror. Për hemisferën veriore, orientimi optimal është në jug. Për hemisferën jugore, orientimi optimal është në veri. Këndi i Azimutit³ tregon shmangien këndore nga orientimi optimal i modulit fotovoltaik.

Sipas IEC 61194, vlerat pozitive të këndit të Azimutit tregojnë për orientim në perëndim, ndërsa vlera negative të këndit tregojnë për orientim në lindje.

Për të iu shmangur zvogëlimit të performancës, modulit fotovoltaik duhet t'i sigurohet ventilim i mirë. Kjo bëhet për të kufizuar ndryshimet në temperaturë. Sipas udhëzimit CEI 82-24, (II ed.) ndryshimi i tensionit pa-ngarkesë V_{OC} të modulit fotovoltaik në krahasim me tensionin pa-ngarkesë të modulit në kushte standarde të testimit, $V_{OC,STC}$ në funksion të temperaturës së operimit të qelive fotovoltaike shprehet përmes:

$$V_{OC}[T] = V_{OC,STC} - N_S \cdot \beta \cdot (25 - T_{CEL})$$

Ku,

β – koeficienti i ndryshueshmërisë së tensionit të modulit sipas temperaturës

N_S - numri i qelive të modulit të lidhura në seri

Gjatë dizajnit të sistemit solar fotovoltaik është e rëndësishme të eliminohet hija e drejtpërdrejtë. Sipas studimit të INES⁴, nëse 10% e sipërfaqes së një vargu ka kontakt direkt me hije, rezulton në 30% të reduktimit në prodhim.

Në rastet kur hija është e pashmangshme duhet të dizajnohet në atë mënyrë që hija të përfshijë vetëm një varg.

³ Në astronomi, këndi i Azimutit përkufizohet si distanca këndore përgjatë horizontit, i matur nga veriu (0°) në lindje, nga pika e prerjes së rrethit vertikal që kalon përmes objektit.

⁴ Instituti kombëtar I Francës për energji solare.

4.2. Pajisjet e sistemit solar fotovoltaik

Elementet e sistemit solar fotovoltaik të kyçur në rrjet janë: moduli fotovoltaik(1), mbrojtja DC (2), invertori(3), mbrojtja AC(4), kabllimi DC (kaltër), kabllimi AC(kuqe), pika e kyçjes së objektit në rrjetin elektrik(5).




Figura 9. Elementet e sistemit solar fotovoltaik të kyçur në rrjet.

4.2.1. Moduli fotovoltaik

Moduli fotovoltaik është pajisja prodhuese e sistemit solar fotovoltaik. Kjo pajisje përbëhet nga qelitë fotovoltaike të montuara në një kornizë. Qelitë fotovoltaike përbëhen nga materiali gjysmë përçues përmes së cilit bëhet shndërrim i energjisë së diellit në rrymë elektrike të vazhdueshme. Këto qeli lidhen në seri me njëra tjetrën, duke formuar një modul fotovoltaik. Modulet fotovoltaike të zakonshme janë me 60 apo 72 qeli. Modulet fotovoltaike duhet të jenë të prodhuara sipas standardit EN 50521. Karakteristikat e moduleve fotovoltaike përcaktohen nga prodhuesi në kushte standarde të testimit, STC. Të dhënat teknike të cilat vendosen në fletën e të dhënave të modulit fotovoltaik, sipas standardit DIN EN 50380 duhet të përmbajë vlerat për:

Fuqinë Nominale, Tensionin Nominal, Rrymën Nominale, Tensionin e lidhjes së hapur, Rrymën e lidhjes së shkurtë dhe eficiencën nominale. Të gjitha vlerat duhet të jenë të llogaritura nën kushtet standarde të testimit. Përveç të dhënave elektrike, në fletën e të dhënave duhet të përfshihen edhe të dhënat mbi madhësinë, peshën, vlerat kufitare të stresit mekanik dhe termal, si dhe varshmëria në temperaturë. Meqenëse modulet fotovoltaike përbëjnë pjesën më të madhe

të investimit, duhet të sigurohet kualiteti dhe qëndrueshmëria e tyre. Për këtë arsye, modulet fotovoltaike duhet të jenë të certifikuara sipas instituteve testuese të njohura.

Standardet bazë që duhet të respektohen nga laboratorit testues për certifikim të moduleve fotovoltaike janë IEC 61215 dhe IEC 61646.

Standardi bazë që duhet respektuar për të bërë vlerësimin e performancës së modulit fotovoltaike është IEC 60904.

Standardi bazë që duhet respektuar për testim ndaj impaktit të ngarkesave mekanike në relacion me dëmet është IEC 61724.

Një kriter tjetër i rëndësishëm është gjatësia e periudhës së garancionit të prodhuesit. Garancioni i prodhuesit duhet të jetë mes 2 (e detyrueshme është dy vjet) – 30 vjet. Ndërsa, garancioni i performancës siguron një performancë minimale për një periudhë të caktuar kohore. Zakonisht zgjasin mes 10 deri në 30 vjet. Garancioni i performancës duhet të jetë i qartë se a qëndron për performancë minimale apo nominale.

4.2.2. Invertori

Invertori duhet të bëjë shndërrimin e rrymës së vazhdueshme të prodhuar nga moduli fotovoltaike në rrymë alternative me frekuencë dhe tension të përshtatshëm për sistemin elektrik të ndërtesës ku është implementuar sistemi solar fotovoltaike.

Një inverter kryen këto funksione në sistemin solar fotovoltaike: shndërron rrymën e vazhdueshme të prodhuar nga modulet fotovoltaike në rrymë alternative, përmes gjurmuesit përshtatë pikën e punës së inverterit në pikën e fuqisë maksimale të modulit fotovoltaike, monitoron dhe regjistron të dhënat e prodhimit të sistemit solar fotovoltaike.

Parimi i punës varet në elementet e elektronikës energjetike. Këto elemente i mundësojnë inverterit të punojë në kushte optimale. Për t'a bërë këtë përdoret një qark elektronik i cili e përshtatë tensionin në atë mënyrë që inverteri të punojë në pikën në të cilën vargu apo grupi i moduleve fotovoltaike arrinë fuqinë maksimale. Ky njihet si gjurmues i pikes më të lartë të fuqisë. Ky gjurmues siguron që fuqia më e madhe e mundshme transferohet në rrjetin elektrik apo ngarkesën e ndërtesës.

Të dhënat teknike të cilat vendosen në fletën e të dhënave të inverterit duhet të bazohet në standardin DIN EN 50524, në relacione të standardizuara. Edhe efienca në tension maksimal, minimal dhe nominal duhet të tregohet në relacion me fuqinë e standardizuar dalëse. Po ashtu, duhet të ofrohen të dhëna mbi reduktimin në fuqi që mund të shkaktohet si pasojë e ndryshimit në temperaturë. Përveç, fletës së të dhënave me inverterin duhet të mundësohet edhe udhëzuesi i montimit dhe operimit të inverterit së bashku me garancionin nga prodhuesi. Garancionet standarde janë valide prej 2 deri në 5 vjet.

Sipas standardit VDE 0100 Part 712 sistemet solare fotovoltaike obligohen të kenë ndërprerës DC në mes të pjesës DC dhe inverterit. Disa prodhues ofrojnë inverterë me siguresa të integruara që zëvendëson ndërprerësin.

4.2.3. Kabllot

Për instalimin e një sistemi solar fotovoltaike duhet të përdoren përçues specifik të cilat kanë qëndrueshmëri për tërë jetëgjatësinë e sistemit solar fotovoltaike, durojnë kushte ekstreme të atmosferës, temperatura të larta dhe janë rezistente ndaj rrezeve ultravjollcë. Duhet të jenë të prodhuara për të punuar në nivel të njëjtë të tensionit si i tërë sistemi. Përçuesit të cilët përdoren në sistemet solare fotovoltaike janë: përçuesit solar dhe përçuesit alternativ.

4.2.3.1. Kabllo solare

Përmes kabllimit DC, bëhet lidhja elektrike e moduleve fotovoltaike me pjesën tjetër të sistemit solar fotovoltaike.

Kabllimi DC duhet të bëhet sipas standardit IEC 60364-7-712 dhe 60364-5-52 dhe duke respektuar udhëzimet shtesë të furnizuesit. Pikat kyçe që duhet pasur parasysh gjatë kabllimit DC janë: fiksimi i sigurtë, kontakti i sigurtë dhe i qëndrueshëm, instalim i qëndrueshëm ndaj motit, përballimi i një brezi të gjerë të temperaturave (-55°C deri 125°C) dhe aftësia e rezistimit ndaj rrezeve ultra vjollcë.

Kabllot me një bërthamë dhe izolim të dyfishtë ka rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe konsiderohen si zgjidhje e përshtatshme për kabllimin DC. Këto kablllo njihen si kablllo solare dhe janë të klasifikuara si PV1-F. Në rast se nuk respektohen këto karakteristika mund të kemi lidhje të dobët, hark elektrik, rrezik nga zjarri etj.

Sipas IEC 60364-5-52 kabllimi nuk duhet të dëmtohet nga lidhëset e kablllove. Kujdes i madh duhet të bëhet gjatë lidhjes së kablllove të vargut apo kablllove tjera DC. Kjo në mënyrë që të shmangen harqet të cilat mund të shkaktojnë rrezik nga zjarri. Në rast se nuk përdoren konektorët, për të iu shmangur rrezikut të përmendur më lartë, kyçja duhet të bëhet sipas standardit DIN 46228. Nëse përdoren konektorët, duhet të sigurohemi që konektorët e zgjedhur i janë përmbajtur kërkesave të sigurisë sipas IEC 62852:2014. Nuk ka ndonjë formë fizike të standardizuar të konektorëve.

Sipas IEC 60364-7-712 kabllimi duhet të bëhet në atë mënyrë që gjatësitë e përçuesve dhe sipërfaqja e krijuar në mes tyre të jenë më të vogla të mundshme. Në rastet kur nuk mund të respektohen të dyja këto kushte, prioritet ka mbajtja e sipërfaqes së krijuar në mes të kablllove në sa më të vogël të mundshme. Kjo në mënyrë që të zvogëlohet tensioni i shkaktuar nga goditjet elektrike.

4.2.3.2. Kabllot alternative

Kabllot alternative – kabloja e cila e lidhë inverterin me rrjetin elektrik përmes pajisjeve mbrojtëse. Dimensionimi i kabllot AC duhet të bëhet sipas VDE 0298 pjesa e 4, sipas së cilës kablo alternative duhet të ketë kapacitet të bartë rrymë më të lartë se rryma maksimale të cilën mund ta prodhojë inverteri. Kjo vlerë gjendet në fletën e të dhënave të inverterit. Sipas DIN 18015, për mbrojtje ndaj devijimeve të mundshme të tensionit, gjatë kalkulimit të seksionit të përçuesit alternativ mund të llogaritet një rënie e tensionit prej 3%.

Në rast të inverterëve trefazorë, kyçja në nivelin e ulët të tensionit duhet të bëhet me kablo 5 fijore. Për inverterët një fazorë, kyçja duhet të bëhet me kablo 3 fijore. Kabllot mund të jenë të tipit NYM, NYY ose NYCWY.

4.2.4. Mbrojtja e sistemit solar fotovoltaik

Më poshtë janë paraqitur kushtet për mbrojtjen e sistemit solar fotovoltaik në pjesën DC, pjesën AC dhe ndaj dëmeve të mundshme të mbitensioneve, goditjeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të rrufesë.

4.2.4.1. Rreziku nga zjarri

Në një sistem solar fotovoltaik në përgjithësi ka tri situata që mund të çojnë në temperatura të larta jonormale dhe në rrezik nga zjarri: dëmtimi i izolimit, rryma kthyese në panelet PV, dhe mbi-rrymat, ndaj të cilave duhet të mbrohet.

- Dëmtimi i izolimit . Duhet të sigurohet mbrojtje ndaj dëmtimeve të mundshme të izolimit që mund të shkaktohen. Kjo për arsye se njerëzit përreth mund të kenë kontakt direkt me pjesët e ekspozuara. Inverteri ka aftësi të detektojë dëmtim të tillë dhe ta shkryc veten mirëpo jo edhe ta shuajë dëmtimin. Përderisa modulet fotovoltaike do të jenë të ekspozuara në diell do të ketë tension të pranishëm.

Kjo do ta rritë mundësinë për shkaktimin e harkut elektrik, rrjedhimisht dëmtimi do të vazhdojë të jetë i pranishëm.

Sipas IEC 60364 kabllot solare duhet të kenë izolim të dyfishtë apo të përforcuar si masë mbrojtëse nga harku elektrik. Mbrojtja bazike ofrohet nga izolimi parësor ndërsa mbrojtja nga dëmtimi ofrohet nga izolimi plotësues.

- Rrymat kthyese. Si pasojë e hijeve apo ndonjë lidhjeje të shkurtë, një varg mund të bëhet element pasiv i cili merr dhe liron energjinë elektrike të prodhuar nga vargjet tjera të lidhura paralel me të. Kur vargu bëhet element pasiv në të mund të fillojë të rrjedhë një rrymë në drejtim të kundërt me atë të operimit standard dhe të shkaktojë dëme në modulet fotovoltaike.

Për rastet kur ekziston vetëm një varg nuk ka rrezik nga rrymat kthyese. Vlera e rrymës është e vogël dhe mbrohet nga diodat e modulit fotovoltaiik.

Sipas IEC TS 62257-7-1 modulet fotovoltaike mund të durojnë një rrymë kthyese prej 2.5 deri 3 I_{scmax} . Meqë në rastet kur ka x vargje të lidhura paralel, rryma kthyese maksimale është e barabartë me:

$$I_{kth} = (x - 1) \cdot 1.25 \cdot I_{sc}$$

Nuk është e nevojshme të mbrohen stringjet për $I_{kth} \leq 2.5 \cdot I_{sc}$.

Dmth,

$$(x - 1) \cdot 1.25 \cdot I_{sc} \leq 2.5 \cdot I_{sc} \Rightarrow x \leq 3$$

Sipas IEC TS 62257-7-1, për rastet kur ka 4 vargje apo më shumë, për secilin varg duhet të përdoren siguresat fotovoltaike me karakteristika sipas fletës së të dhënave të modulit fotovoltaiik.

Deri më tash standardi IEC 60269-6 CDV 10/2009 është i vetmi i cili trajton kushtet specifike të punës për siguresat e tilla në sisteme solare fotovoltaike. Siguresat e prodhuara sipas këtij standardi janë të shenjëzuara si gR apo gPV.

4.2.4.2. Mbrojtja nga mbirrymat

Sipas standardit IEC 60364-7-712, nuk ka nevojë për mbrojtje nga mbi-rrymat në anën DC në rast se përçuesi solar dimensionohet të bartë kapacitet jo më të vogël se rryma më e lartë që mund ta dëmtojë atë. Dmth,

$$I_{kablllo} = 1.25 \cdot I_{sc}$$

Ku,

I_{sc} – rryma e lidhjes së shkurtë e modulit fotovoltaiik në kushte standarde të testimit

1.25 – rritja për 25% merr parasysh vlerat e diellosjes që tejkalojnë 1kW/m²

Sa i përket lidhjeve të shkurta, përçuesit solar mund të ndikohen prej mbi-rrymave të tilla në rast se: ka lidhje të shkurtë në mes të polariteteve të sistemit solar fotovoltaiik, lidhjes së shkurtër me tokën, lidhje e dyfishtë me tokën. Për mbrojtje ndaj këtyre lidhjeve të shkurta pajisjet mbrojtëse do të vendosen në fund të qarkut që do të mbrohet (fillimi te vargu, fundi te inventori).

Sipas standardit IEC TS 62257-7-1 pajisjet mbrojtëse duhet të kenë tension nominal U_n , të barabartë ose më të lartë se tensioni maksimal i gjeneratorit fotovoltaiik.

$$U_n \geq V_{mgjf}$$

Ku,


$$V_{mgjf} = 1.2 \cdot U_{oc}$$

V_{mgjf} – tensioni maksimal i gjeneratorit fotovoltaiik, U_{oc} – tensioni pa ngarkesë i vargut

4.2.4.3. Mbrojtja nga mbirrymat në anën AC

Meqë përçuesi i cili përdoret për kyçe të inverterit me rrjetin elektrik, zakonisht dimensionohet për të bartur rrymë me kapacitet më të lartë se rryma maksimale të cilën inverteri mund t'a prodhojë, nuk paraqitet nevojë për mbrojtje ndaj mbirrymave në anën AC. Sidoqoftë, përçues duhet të mbrohet ndaj rrymës së shkurtë që mund të shkaktohet nga rrjeti (kontributi i inverterit në rrymën e shkurtë është i neglizhueshëm).

Kjo mbrojtje bëhet përmes një pajisje mbrojtëse e cila vendoset afër pikës së kycjes me rrjetin. Në rastin e një inverteri mund të përdoret ndërprerësi kryesor i ndërtesës, reagimi i së cilit e shkycë plotësisht objektin. Në rast se kemi shumë inverterë, preferohet mbrojtje për secilin inverter si në figurë (X i kuq për çdo pajisje).



4.2.4.4. Mbrojtja nga mbitensionet

Meqenëse sistemet solare fotovoltaike gjinden të instaluar jashtë mund të jenë pre e shkarkimeve atmosferike të drejtpërdrejta apo jo të drejtpërdrejta.

Sipas standardit IEC 61643-31:2018 përcaktohet pajisja mbrojtëse për pjesën DC të sistemeve solare fotovoltaike deri në 1500 V DC të kycura në rrjet.

- **Mbrojtja nga goditjet e drejtpërdrejta**

Sipas IEC 62305-2 është e nevojshme të bëhet një analizë e rrezikut si pasojë e goditjes së rrufesë për tu marrë parasysh gjatë instalimit të sistemit solar fotovoltaik. Sipas udhëzimit të prodhuesit DEHN mbi sistemet e mbrojtjes ndaj rrufesë, instalimi i sistemit solar fotovoltaik në kulm nuk ndikon në rritjen e shpeshtësisë së goditjeve të rrufesë të ndërtesës. Por, një interferencë e dukshme e rrufesë mund të injektohet në ndërtesë përmes sistemit solar fotovoltaik. Për mbrojtje të sistemit solar fotovoltaik nga goditjet e drejtpërdrejta përdoren shiritat mbrojtës dhe pranuesit e rrufesë, gjithmonë duke pasur parasysh shmangien maksimale nga shkaktimi i hijeve në modulet fotovoltaike.

Sipas DIN EN 62305-3 përshkruhen kërkesat që sistemi i mbrojtjes ndaj rrufesë i klasës III duhet ti përmbushë për mbrojtje të sistemit solar fotovoltaik. Sipas udhëzimit gjerman VdS 2010, sistemet solare fotovoltaike të instaluar në kulm (>10kWp) duhet të kenë nivel III të mbrojtjes ndaj rrufesë, sistemi i mbrojtjes ndaj rrufesë të klasës III dhe të merren masa për shkarkim të mbitensionit.

Sipas IEC 60364-4-44, shkarkuesit e mbitensionit duhet të instalohen në objekte komerciale apo industriale të cilat nuk kanë sistem të jashtëm të mbrojtjes ndaj rrufesë. Sipas pjesës 5 të standardit gjerman DIN EN 62305-3 përcaktohen karakteristikat e shkarkuesve të mbitensionit dhe lokacionin se ku duhet vendosur ata.

Në rast se analiza e rrezikut për ndërtesë sugjeron që duhet të instalohet një sistem i jashtëm për mbrojtje ndaj rrufesë, duhet referuar pjesës së tretë të VDE 0185.305 në të cilin përshkruhen metodat për dizajnimin e sistemit të mbrojtjes ndaj rrufesë.

Korniza e modulit fotovoltaik duhet tokëzuar efektivisht duke e vendosur sistemin solar fotovoltaik në distancë të ndarjes s^5 e cila llogaritet sipas IEC 62305-3. Sistemi solar fotovoltaik duhet të gjendet në hapësirën e mbrojtur nga sistemi i mbrojtjes ndaj rrufesë.

Tokëzimi duhet të bëhet përmes përçuesit të bakrit me seksion të paktën 6mm^2 apo përçues tjetër ekuivalent me të.

Në rast se nuk mund të respektohet distanca e ndarjes s , konstruksioni duhet të lidhet drejtpërdrejtë me sistemin e jashtëm të mbrojtjes ndaj rrufesë. Rrjedhimisht, këta përçues bëhen pjesë e sistemit të mbrojtjes ndaj rrufesë dhe duhet të kenë kapacitet për përçim të rrymave të rrufesë. Përçuesi të jetë i bakrit me seksion minimal 16mm^2 apo ekuivalent. Në këtë rast duhet të instalohet një shkarkues i mbitensionit për mbrojtje direkte të rrufesë Tipi 1, Tensioni nominal maksimal $U_e \geq 1.1 \cdot U_o$, nivel të mbrojtjes $U_p \leq U_{inv}$, rrymë nominale të shkarkimit $I_n \geq 25\text{kA}$ për secilin pol.

- ***Mbrojtja nga goditjet jo të drejtpërdrejta***

Probabiliteti që një objekt të jetë pre e një goditje jo të drejtpërdrejtë është shumë më i lartë se sa të goditet drejtpërdrejtë nga rrufeja. Efektet e goditjes jo të drejtpërdrejtë prodhojnë mbitensione ndaj të cilave duhet të mbrohet i tërë sistemi elektrik i objektit, e rrjedhimisht edhe sistemi solar fotovoltaik. Në rast se objekti ka sistem të brendshëm të mbrojtjes ndaj rrufesë, në të janë të përfshira të gjitha pajisjet për mbrojtje ndaj goditjeve jo të drejtpërdrejta të rrufesë. Barazimi i

⁵ Distanca për të cilën duhet shmangur modulin fotovoltaik nga sistemi i jashtëm i mbrojtjes ndaj rrufesë, ashtu që në rast të goditjes së rrufesë në sistemin e jashtëm të mbrojtjes, të shmangen shkarkime të pakontrolluara të tensionit.

potencialeve sipas IEC 364-5.54 është parakusht për funksionimin e sistemit të brendshëm të mbrojtjes ndaj rrufesë. Të gjitha elementet e mundshme përçuese të sistemit solar fotovoltaik duhet të jenë të kyçura në sistemin e tokëzimit.

Goditja e tillë mund të shkaktojë mbitension në modulet fotovoltaike dhe përçuesin solar (ose përçuesin kryesor DC). Në mënyrë që të zvogëlohet mbitensioni në përçuesit solar, përçuesit pozitiv dhe negativ të secilit varg duhet të shtrihen sa më afër njëri tjetrit.

Në rast se nuk ka mbrojtje ndaj rrufesë, preferohet barazim i potencialeve me përçues bakrit 6mm² prej kornizës së moduleve deri te zbarra kryesore e tokëzimit. Në anën DC mbrojtja duhet të realizohet përmes shkarkuesit të mbitensionit me karakteristika:

- Tipi 2,

Tensioni nominal maksimal i shërbimi $U_e \geq 1.25 \cdot U_{oc}$,

Nivel të mbrojtjes $U_p \leq U_{inv}$,

Rrymë nominale të shkarkimit $I_n \geq 5kA$.

Mbrojtje termale me mundësi të shuarjes së rrymës së lidhjes së shkurtë.

Në anën AC shfaqet rrezik ndaj mbitensioneve që vijnë përmes vetë linjës. Në rastet kur invertori ka transformator nuk ka nevojë për shkarkues të mbitensionit, sepse mbrojtjen e tillë e kryen vetë transformatori.

Në rastin kur invertori nuk ka transformator, është e nevojshme të instalohet një shkarkues i mbitensionit me karakteristika:

- Tipi 2,

Tensioni nominal maksimal i shërbimi $U_e \geq 1.1 \cdot U_o$, tensioni me tokën për sistem TT, TN;

Nivel të mbrojtjes $U_p \leq U_{inv}$, ku U_{inv} tensioni i durimit të impulsit në anën AC

Rrymë nominale të shkarkimit $I_n \geq 5kA$ për secilin pol

Mbrojtje termale me mundësi të shuarjes së rrymës së lidhjes së shkurtë.

Tokëzimi dhe barazimi i potencialeve - Mbrojtje efektive ndaj mbitensionit është barazimi i potencialeve dhe tokëzimi.

Rekomandohet tokëzimi i konstruksionit dhe integrimi i tij në barazim të potencialit. Për objektet të cilat kanë sistem të mbrojtjes ndaj rrufesë, duhet që konstruksioni të jetë i barazuar potencialisht.

4.2.5. Konstruksioni

Sistemi solar fotovoltaik konsiderohet të jetë strukturë e ndërtesës andaj duhet respektuar kodet dhe rregulloret kombëtare respektive. Konstruksioni duhet të dizajnohet ashtu që ngarkesat e ndryshme të mos bëjnë që sistemi solar fotovoltaik të rrëshqet, rrotullohet apo të fluturojë. Pikat kritike për një konstruksion të sigurt janë: fiksimi i sigurt, bymimi, përshtatshmëria dhe barazimi i potencialeve (tokëzimi mbrojtës).

Sipas standardeve DIN EN 60364-4, 60364-5, 60364-7 përcaktohen kërkesat bazike të konstruksionit ashtu që të mundësohet operim i sigurt elektrik dhe mekanik për tërë jetëgjatësinë e sistemit solar fotovoltaik. Për zvogëlim deri në minimum të forcave të jashtme që mund të veprojnë në sistemin solar fotovoltaik, gjatë planifikimit duhet të merret parasysh:

- Hapësira mes modulit fotovoltaik dhe shtresës së fundit të kulmit nuk duhet të jetë shumë e madhe. Në të njëjtën kohë duhet të jetë e madhe mjaftueshëm që të mundësojë ventilim të mjaftueshëm pa ngujuar gjethë të cilat mund të pengojnë në kullimin e shiut. Sipas DIN 4108.3, një hapësirë prej 200cm² ⁶.
- Modulet fotovoltaike nuk duhet të kalojnë kufijtë vertikal dhe horizontal të ndërtesës (kreshtës, strehës apo pjesëve tjera shtesë të kulmit).
- Modulet fotovoltaike, të vendosura në kulm, duhet të jenë në të njëjtën pjerrësi si kulmi.
- Nëse modulet fotovoltaike nuk montohen të ngjitura në kulm por lihet hapësirë mes kulmit dhe modulit fotovoltaik, atëherë kompensimi i shtypjes arrihet më lehtë. Kjo po ashtu i shmang fishkëllimat që mund të shkaktohen nga era.

Për stabilitet dhe siguri të sistemit solar fotovoltaik, ndikimi i ngarkesave të erës, borës dhe vetë sistemit solar fotovoltaik duhet të përcaktohet nga një inxhinier i statikës, sipas rregullores së vendit dhe standardit DIN 1055.

Për mbrojtje të konstruksionit ndaj korrozionit EN ISO1461 rekomandon që shtresa e galvanizuar të jetë më së paku 15µm. Për galvanizim copë-copë shtresa e galvanizimit duhet të jetë së paku 55µm.

Mundësitë për korrodin të konstruksionit zvogëlohen në minimum kur:

- ndryshimi në potencial mes dy metaleve është në minimum,
- kur metalet që përdoren krijojnë një shtresë që pengojnë korrozionin, dhe
- kur minimizohet përçueshmëria e elektroliteve.

⁶ *Planning and installing Photovoltaic Systems – German Solar Energy Society*

4.3.Projekti elektrik

4.3.1. Dimenzionimi i sistemit solar fotovoltaik

- Përzgjedhja e modulit fotovoltaik dhe karakteristikat e tij:

Prodhuesi:	LONGi
Emërtimi:	LR5-72HGD-585M
Tipi i modulit fotovoltaik:	Half-cut 72 Cells
Fuqia nominale në dalje:	585 Wp
Eficienca e modulit fotovoltaik:	22.6%
Rryma e lidhjes së shkurtë, I _{sc} :	14.30 A
Tensioni i lidhjes së hapur, Voc:	51.52 V
Koeficienti i temperaturës – Voc:	-0.23%/°C
Koeficienti i temperaturës – I _{sc} :	0.045%/°C
Tensioni MPP – V _{mpp} :	43.33 V
Rryma MPP – I _{mpp} :	13.51 A
Tensioni maksimal i sistemit:	1500 V
Teknologjia e qelisë:	Mono

- Përzgjedhja e inverterit dhe karakteristikat e tij:

Prodhuesi:	SUNGROW
Emërtimi:	SG125CX-P2
Tipi i inverterit:	Trefazorë, me vargje
Fuqia nominale AC [kVA]:	125
Tensioni maksimal hyres i DC [V]:	1100
Rryma maksimale AC [A]:	181.1
Tensioni nominal DC [V]:	600
Numri i MPPT:	12
Numri i hyrjeve në MPPT:	24
Tensioni minimal V _{mpp} i inverterit [V]:	180
Tensioni maksimal V _{mpp} i inverterit [V]:	1000
Rangu i punës [V]:	180-1000
Faktori i fuqisë:	0.99

4.3.1.1. Dimenzionimi i vargut

Në $T = -10^{\circ}\text{C}$, dhe $T = 70^{\circ}\text{C}$

$$k(-10) = V_{OC,modul} \left[1 - \left(\left(\frac{V_{Coef}}{100} \right) * (25 - T) \right) \right]$$

$$k(70) = V_{MPP,modul} \left[1 - \left(\left(\frac{V_{Coef}}{100} \right) * (25 - T) \right) \right]$$

$$n_{\min(-10^{\circ}\text{C})} = \frac{V_{\min,mpp.inv}}{k(-10^{\circ}\text{C})}$$

$$n_{\max(-10^{\circ}\text{C})} = \frac{V_{\max,mpp.inv}}{k(-10^{\circ}\text{C})}$$

$$n_{\min(70^{\circ}\text{C})} = \frac{V_{\min,mpp.inv}}{k(70^{\circ}\text{C})}$$

$$n_{\max(70^{\circ}\text{C})} = \frac{V_{\max,mpp.inv}}{k(70^{\circ}\text{C})}$$

Numri i moduleve fotovoltaike të lidhura në varg, n_s duhet të jetë në brezin:

$$n_{\min(70)} \leq n_s \leq n_{\max(-10)}$$

Sipas të dhënave teknike të modulit fotovoltaike dhe inverterit të përzgjedhur, brezi i vargut të dimensionuar është:

Në varg mund të vendosen module fotovoltaike mes:	
$n_{\min(70)}$	15
$n_{\max(-10)}$	20

4.3.2. Llogaritjet elektrike

4.3.2.1. Llogaritja e seksionit dhe rënies së tensionit në kabllon e vargut

Sipas **NEC A. 690.8 A1** llogaritja e rrymës maksimale të vargjeve me module fotovoltaike duhet të llogaritet sipas metodave të mëposhtme:

1. Shuma e rrymave nominale të lidhjes së shkurtër të moduleve fotovoltaike të lidhura paralel shumëzuar me 125%.
2. Për sistemet solare fotovoltaike me kapacitet prodhues 100kW apo më shumë, rryma maksimale e llogaritur duhet të bazohet në vlerën mesatare më të madhe të rrymës për 3 orë, nxjerrë nga simulimi i rrezatimit lokal për vargun e caktuar duke marrë parasysh orientimin dhe lartësinë. Vlera e llogaritur sipas kësaj mënyre nuk duhet të jetë më e vogël se 70% e vlerës së kalkuluar në sipas pikës 1.

Rrymat e sistemit solar fotovoltaik konsiderohen të jenë të vazhdueshme. Përçuesit e qarkut elektrik duhet të dizajnohen të përçojnë rrymë me kapacitet jo më të ulët se rryma e llogaritur sipas metodës 1. Në rastin kur qarku mbrohet nga një pajisje mbrojtëse nga mbi-rrymat, përçuesi duhet ta përballojë rrymën nominale të pajisjes.

Rënia e tensionit

Rënia e tensionit llogaritet sipas:

$$u = \frac{K \cdot P \cdot l \cdot 10^5}{k \cdot S \cdot U^2}$$

Ku,

u - Rënia e tensionit

K - Koeficienti, $K=1$ për përçues trefazorë, $K=2$ për përçues njëfazor

P - Fuqia e tërë (W)

l - Gjatësia e kabllos (m)

k - Përçueshmëria specifike (Për Cu, $k=57\text{m/mm}^2 \Omega$)

S - Prerja tërthore e përçuesit (mm^2)

U - Tensioni i punës (V)

Sipas BS 7671, përçuesi solar duhet të dizajnohet ashtu që rënia e tensionit në kushte standarde të testimit mes vargut dhe invertorit të jetë më e vogël se 3%.

4.3.2.2. Llogaritja e seksionit dhe rënies së tensionit në përçues AC

Sipas **NEC A. 690.8 A3**, rryma maksimale AC llogaritet të jetë rryma nominale në dalje të invertorit. Kjo vlerë për invertorin e përzgjedhur gjindet në fletën e të dhënave të invertorit.

- **Rënia e tensionit**

Rënia e tensionit llogaritet sipas:

$$u = \frac{K \cdot P \cdot l \cdot 10^5}{k \cdot S \cdot U^2}$$

Ku,

u - Rënia e tensionit

K - Koeficienti, $K=1$ për përçues trefazorë, $K=2$ për përçues njëfazor

P - Fuqia e tërë (W)

l - Gjatësia e përçuesit (m)

k - Përçueshmëria specifike (Për Cu, $k=57\text{m/mm}^2 \Omega$)

S - Prerja tërthore e përçuesit (mm^2)

U - Tensioni i punës (V)

Sipas BS 7671, rekomandohet që për përçues t AC në mes të inverterit dhe tabelës shpërndarëse të konsumatorit të kenë rënie të tensionit 1% ose më të ultë. Sidoqoftë, për sisteme solare fotovoltaike me kapacitete të mëdha ky rekomandim mund të mos përfillet për mos arsyeshmërinë ekonomike si pasojë e rezultimit në seksion shumë të lartë të përçuesit. Rekomandohet që përçuesi të dizajnohet në atë mënyrë që rënia e tensionit të zvogëlohet minimalisht.

4.3.3.Prodhimi i energjisë elektrike nga sistemi solar fotovoltaik

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat në baza mujore, vjetore, dhe për një periudhë 30 vjeçare të energjisë që pritet të gjenerohet nga sistemi solar fotovoltaik i propozuar. Prodhimi i energjisë për këtë periudhë merr parasysh edhe degradimin e sistemit solar fotovoltaik.

Viti	Energjia e prodhuar (kWh)	Zvogëlimi i prodhimit nga degradimi (kWh)	Prodhimi (kWh)
2024	2,405,166	-	2,405,166
2025	2,405,166	72,155	2,333,011
2026	2,405,166	96,207	2,308,959
2027	2,405,166	120,258	2,284,908
2028	2,405,166	132,284	2,272,882
2029	2,405,166	144,310	2,260,856
2030	2,405,166	156,336	2,248,830
2031	2,405,166	168,362	2,236,804
2032	2,405,166	180,387	2,224,779
2033	2,405,166	192,413	2,212,753
2034	2,405,166	204,439	2,200,727
2035	2,405,166	216,465	2,188,701
2036	2,405,166	228,491	2,176,675
2037	2,405,166	240,517	2,164,649
2038	2,405,166	525,542	2,152,624
2039	2,405,166	264,568	2,140,598
2040	2,405,166	276,594	2,128,572
2041	2,405,166	288,620	2,116,546
2042	2,405,166	300,646	2,104,520
2043	2,405,166	312,672	2,092,494
2044	2,405,166	324,697	2,080,469
2045	2,405,166	336,723	2,068,443
2046	2,405,166	348,749	2,056,417
2047	2,405,166	360,775	2,044,391
2048	2,405,166	372,801	2,032,365
2049	2,405,166	384,827	2,020,339
2050	2,405,166	396,852	2,008,314
2051	2,405,166	408,878	1,996,288
2052	2,405,166	420,904	1,984,262
2053	2,405,166	432,930	1,972,236
Energjia e prodhuar për 30 vite:			64,518,577

4.4. Operimi dhe mirëmbajtja

4.4.1. Operimi

Secili sistem solar fotovoltaik kërkon mirëmbajtje minimale për të operuar me rendiment të lartë. Një sistem solar fotovoltaik cilësor planifikohet të ketë jetëgjatësi 25 deri në 30 vite. Me një kujdes të duhur do t'ju garantohet një prodhim i qëndrueshëm dhe maksimal për periudhë të gjatë kohore.

- **Pastrimi i paneleve solare**

Preferohet që modulet fotovoltaike të pastrohen periodikisht në mënyrë që ato të qëndrojnë të pastra nga pluhuri dhe papastërtitë tjera, ashtu që të punojnë me efikasitet maksimal. Pastrimi i moduleve fotovoltaike është një procedurë e thjeshtë që mund të kryhet aq shpesh sa kërkohet, në varësi se sa grumbullohen papastërtitë. Për të pastruar panelet, mund të përdorni një leckë të butë dhe të lagur si dhe sapun të biodegradueshëm. Nëse doni ta pastroni vetëm pluhurin, ju mund ta bëni atë vetëm duke hedhur ujë mbi modulet fotovoltaike.

- **Shmangia e hijeve**

Rritja e pemëve të cilat mund të shkaktojnë hije në periudha të ndryshme të vitit duhet të monitorohen dhe të trajtohen në vazhdimësi.

- **Monitorimi i sistemit solar**

Në periudha javore duhet të siguroheni që invertorët janë duke punuar. Kjo mund të bëhet duke kontrolluar funksionimin e invertorëve përmes platformës online apo duke kontrolluar ekranin dhe LED dritën e gjelbër tek secili invertor.

- **Inspektimi i sistemit solar**

Në vazhdimësi duhet të inspektohen me sy nëse ka dëmtime të moduleve fotovoltaike, përçuesve, invertorëve apo pajisjeve tjera.

4.4.2. Mirëmbajtja dhe obligimet e mirëmbajtësit

Nëse vëreni se sistemi solar fotovoltaik nuk është në operim të rregullt apo ekziston ndonjë defekt tjetër, menjëherë duhet të njoftohet kompania instaluese dhe në asnjë mënyrë të mos ndërhyjni vet. Të mos preket apo të tërhiqet përçuesi i invertorit, e as përçuesit tjerë të sistemit solar dhe në asnjë mënyrë mos të shkelet me këmbë mbi modulet fotovoltaike.

Në rast se ndonjë modul fotovoltaik apo invertor është dëmtuar fizikisht asnjëherë nuk duhet të preket me dorë sepse pajisjet janë nën tension dhe mund të goditen nga elektroshoku. Në këtë rast duhet të shkyçen ndërprerësit e sistemit në pjesën DC dhe AC. Më pastaj duhet të njoftohet kompania instaluese për situatën e krijuar.

Nuk lejohet pastrimi i moduleve fotovoltaike me ujë të ftohtë në rastet kur ato janë të ekspozuara në temperatura të larta. Pastrimi i moduleve fotovoltaike duhet të bëhet me ujë të ngrohtë apo të

bëhet në rastin kur nuk kanë temperaturë të lartë. Asnjëherë të mos përdoret sfungjer gërryes apo material i vrazhdë për pastrimin e moduleve fotovoltaike sepse mund të shkaktoni dëmtime të pariparueshme duke e gërrisitur xhamin e tij.

Shënim me rëndësi: Shëndeti dhe siguria në punë gjatë mirëmbajtjes së sistemit solar fotovoltaike janë përgjegjësi e mirëmbajtësit/konsumatorit.

4.5. Plani i emergjencës

Sistemi solar fotovoltaike konsiderohet i sigurt nëse të gjitha rreziqet që mund të shkaktohen gjatë instalimit dhe përdorimit të tij adresohen në mënyrë adekuate. Për përmirësim të kësaj sigurie gjatë ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit solar fotovoltaike kërkohet:

- Respektimi i legjislacionit dhe rregulloreve teknike në fuqi,
- Respektimi i udhëzimeve dhe rekomandimeve të prodhuesve,
- Respektimi i të gjitha standardeve aktuale.

- Legjislacioni, rregulloret teknike, standardet dhe rekomandimet:

- **IEC 60364-7-712** - Rregullore mbi instalimet apo vendndodhjet e veçanta të sistemeve solare fotovoltaike.
- **NEC 690.12 A-D** - Rregullore mbi shkyçjen imediate të sistemit solar fotovoltaike në ndërtesë
- **Ligji nr. 04/I-012** - Për mbrojtje nga zjarri.
- **HRN HD 637 S1:2002** - Rregullorja për standardet teknike për pajisjet elektroenergjetike me tensionet nominale të punës 1000V.
- **HRN HD 637 S1** - Rregullore mbi masat teknike për mbrojtjen e pajisjeve elektroenergjetike nga zjarri.
- **HRN EN 60059 i HRN HD 637** - Kushtet e përgjithshme për furnizim me energji elektrike.
- **HRN HD 637 S1** - Rregullore mbi normat teknike për mbrojtjen e pajisjeve elektroenergjetike dhe hapësirave për përdorim si zona energjetike.
- **HRN EN 60265-1:2005** - Rregullore mbi normat teknike për kthinat energjetike për tension mbi 1kV.
- **HRN EN 60265-1:2005** - Rregullore mbi normat teknike për mbrojtje nga lidhjet e shkurta dhe mbitensioni.

Mbrojtja në punë

Sistemi solar fotovoltaike paraqet objekt elektroenergjetik të destinuar për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike të ripërtërishme. Përbëhen nga pjesa elektromontuese dhe pjesa ndërtimore. Pjesa ndërtimore është konstruksioni metalik dhe kuadro metalik shpërndarës,

kurse pjesa elektromontuese: moduli fotovoltai, përçuesit DC dhe AC, mbrojtjet DC dhe AC, si dhe instalimi i tokëzimit.

Gjatë punimit të këtij dokumentacioni teknik janë marrë për bazë zgjidhjet teknike të cilat sigurojnë aplikim të plotë të rregullave të mbrojtjes në punë, ashtu që të sigurohen kushtet e punës pa rrezik për jetën dhe shëndetin e personelit që merr pjesë në ndërtimin e objektit, dhe më vonë në mirëmbajtjen e tij. Përmes dimensionimit mekanik dhe elektrik të elementeve të sistemit solar fotovoltai dhe kyçjes së tij në rrjet janë dhënë zgjidhje teknike që sigurojnë stabilitet statik të objektit, si dhe sigurinë në bartjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Duke marrë parasysh specifikat e këtij lloji të objektit, gjatë aplikimit të rregullës së mbrojtjes në punë, vëmendje të posaçme duhet pasur gjatë fazës së ndërtimit dhe mirëmbajtjes.

Mjetet për mbrojtje personale, pajisjet mbrojtëse dhe veglat izoluese

Mjetet mbrojtëse personale, pajisjet mbrojtëse dhe veglat izoluese duhet të jenë të atestuara dhe kontrolluara sipas standardeve përkatëse.

Në pajisje dhe veglat e punës duhet të ekzistojë shenja e shtypur apo vula mbrojtëse e organizatës e cila ka bërë testimin dhe datën e testimit. Mjetet mbrojtëse personale, pajisjet mbrojtëse dhe veglat izoluese para përdorimit duhet të kontrollohen në mënyre vizuale në rast të ndonjë dëmtimi të dukshëm.

Ekzemplarët e dëmtuar nuk guxojnë të përdoren. Gjatë kohës së manipulimit dhe punës në objekte aplikohen mjete përkatëse të mbrojtjes personale, pajisje mbrojtëse:

- helmata mbrojtëse, përdoret gjatë manipulimit dhe punës në objekt.
- rrobat e punës, shërbejnë si mbrojtëse nga lëndimet mekanike dhe kimike të trupit dhe djegëseve në rast të harkut elektrik gjatë manipulimit dhe punës në objekt.
- çizmet prej gome, shërbejnë si mbathje pune dhe mbrojtëse.
- rripi i sigurisë, shërben për të mbrojtur nga rrëzimi prej lartë, duhet të përdoret detyrimisht gjatë punës në lartësi mbi tri metra.
- kllapat ngjithës për shtylla, shërbejnë për ngjitje të sigurt në shtylla dhe mbështetje rreth tyre gjatë punës
- dorëzat prej gome, shërbejnë si mjet i mbrojtjes gjatë manipulimit të kyçjes dhe shkyçjes.
- dorëzat e lëkurës, shërbejnë për mbrojtjen e duarve nga lëndimet kimike e mekanike
- indikator i tensionit, aplikohet për të vërtetuar gjendjen pa tension.
- pajisjet për realizimin e tokëzimit dhe lidhjes së shkurtër, shërbejnë për sigurimin e vendit ku punohet dhe realizimit të tokëzimit e përkohshëm.

- **Sistemi i lidhjeve për komunikim në punishte**

Komunikimi më i përshtatshëm dhe koordinimi i punëve është nëpërmjet sistemit të radiolidhjeve të dorës. Në rast se vend punishtja është e vogël, atëherë udhëheqësi i punëve është i obliguar të sigurojë mënyrën më të përshtatshme të komunikimit.

- **Punët përgatitore**

Organizimi dhe rregullimi i punishtes sipas planit të rregullimit të punishtes,

Organizimi i hapësirës së deponimit

Organizimi i transportit të punëtorëve, materialeve dhe veglave për punë,

Organizimi dhe mundësimi i dhënies së ndihmës së parë të menjëhershme, në rast të ndonjë lëndimi në vendin e punës.

Masat e mbrojtjes në punë gjatë ndërtimit sistemit diellor fotovoltaik

Punëtorët të cilët punojnë në këtë sistem solar fotovoltaik duhet të jenë në gjendje të mirë fizike dhe psikike, si dhe duhet t'u nënshtrohen kontrollimeve të rregullta mjekësore për punë në lartësi. Këta punëtorë duhet të jenë të kualifikuar për punën të cilën duhet ta kryejnë dhe t'i nënshtrohen testimit periodik të njohurive.

Gjatë kohës së punës, punëtorët nuk guxojnë jenë nën ndikim të alkoolit apo substancave tjera të cilat e zvogëlojnë aftësinë për punë.

Punëtorët janë të obliguar që në mënyrë të saktë, me kohë, dhe me kualitet t'i kryejnë të gjitha operacionet të cilat u janë deleguar nga ekipi inxhinierik. Punëtorët në vendin e punës duhet të kenë mbrojtjen e paraparë higjieno-teknike si vijon: helmetën, dorëzat mbrojtëse, çizmet prej gome, kllapat për ngjitje në shtylla kur nevojitet, rripat dhe pajisjet e tjera të cilat janë të parapara sipas *Rregullores mbi mbrojtjen në punë* për këtë lloj veprimtarie. Pa pajisjet e lartpërmendura të mbrojtjes në punë, punëtori nuk guxon të kryejë veprime në vendin e tij të punës. Masat duhet të merren nga udhëheqësi ashtu që punëtori të jetë i pajisur si më lartë.

Masat e mbrojtjes në punë gjatë operimit të sistemit solar fotovoltaik

Prej momentit kur sistemi solar fotovoltaik fillon të operojë, të gjitha pajisjet elektrike do të jenë të siguruar dhe të sinjalizuara me shenja adekuate standarde.

Kur duhet të kryhen punë në pajisje elektrike dhe ekziston mundësia e prekjes së rastësishme në pjesët nën tension apo rreziku nga fusha elektrike, tensioni më së pari duhet të shkyçet, të bëhet tokëzimi dhe të përdorën të gjitha masat dhe mjetet e sigurisë në punë të cilat janë të parapara me procedurën e shkyçjes dhe kyçjes, rregulla teknike dhe ato të sigurisë në punë.

Para fillimit të punës në ormanin shpërndarës duhet që paraprakisht të bëhet shkyçja e inventorit dhe e ndërprerësit nga ana e rrjetit elektrik.

Në kuadrin e ormanit shpërndarës ekziston skema njëpolare e sistemit solar fotovoltaik në të cilën duhet bazuar për çdo veprim.

Gjatë punës në ormanin shpërndarës, në kuadrin e tij duhet të jetë mbishkrimi *“Mos e kyç, rrezik për jetë”*.

- ***Sigurimi i gjendjes pa tension***

Punët gjatë kabllimit, në modulet fotovoltaike, në inverter apo në orman shpërndarës duhet të kryhen në gjendje pa tension. Gjatë kabllimit, gjeneruesit e mundshëm të tensionit dhe rrymës duhet të jenë të shkyçur ose të izoluar. Përmes shenjzimeve apo metodave tjera duhet siguruar që gjatë punës të parandalohet kyçja e tyre.

- ***Mbrojtja nga zjarri***

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit nga sistemi solar fotovoltaik duhet të plotësohen kushtet si:

- Të gjitha pajisjet elektro-energjetike duhet të mbrohen nga lidhjet e shkurta dhe mbitensioni.
- Të gjitha pajisjet elektrike duhet të jenë pa luhajtje ose me shumë pak luhajtje.
- Të gjitha pajisjet duhet të mirëmbahen dhe përdoren komfor rregullave.

Nëse pajisjet elektro-energjetike të tensionit të mesëm vendosen brenda në objekt duhet të vendosen në atë mënyrë që të ketë mundësi për parandalim të zjarrit.

Kanalet për ventilim në hapësirat ku janë të vendosur inverterët duhet të jenë të dizajnuara në atë mënyrë që në rast të zjarrit flaka të mos e rrezikojë objektin.

Nëse ekziston rreziku i përhapjes së zjarrit atëherë kanalet duhet të jenë nga materiali zjarr-durues dhe ti kenë të vendosura klapetat e zjarrit. Për mbrojtje dhe shpëtim në rast të rrezikut nga zjarri duhet të sigurohen rrugët më të shkurta të evakuimit.

Rrugët e evakuimit duhet të jenë jo më të gjata se 20m deri në pozicionin e sigurtë. Të gjitha dyert e kuadrove duhet të jenë zjarr-durues dhe të hapen nga ana e jashtme.

Pjesa ku vendoset inverteri dhe ormani shpërndarës duhet të jetë punuar nga materiali zjarr-durues.

Kohëzgjatja e rezistimit duhet të jetë mesatarisht 90min, ndërsa për kuadrin dhe dyert e ormanit duhet të jenë rezistuese nga zjarri mesatarisht 30min.

Pozicioni i inverteleve dhe ormanit shpërndarës duhet të jetë i lehtë për qasje në rast të zjarrit.

4.6. Ndikimi i mjedisit në funksion të parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë

- ***Ndikimi i objekteve përreth***

Në mjedisin e Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, nuk ka vegjetacion të lartë, ndërtesa, largpërçues as ndërtesa të cilat mund të bëjnë hijen mbi sistemin e paneleve.

- ***Ndikimi i pluhurit***

Çdo park i energjisë diellor duhet të përbën të gjitha humbjet gjatë prodhimit që mund të ndodhin. Ashtu në lokacionin e projektit, duhet të kalkulohet ndikimi i pluhurit dhe poles lulesh në funksionimit kualitet të panellave diellor.

Gjatë ditëve me shi, modulet fotovoltaike duhet të shpërlahen dhe pasi që thahen kthehen mbrapa në funksionim.

- ***Ndikimi i pluhurit dhe mikro pluhurit në qelizat diellore***

Pluhuri dhe mikro pluhuri gjenerojnë humbjet gjatë funksionimit të panellave diellor. Pluhuri krijon një shtresë të vështirë mbi sipërfaqes e qelizave fotovoltaike dhe kjo redukton insolimin në qelizet fotovoltaike.

Në vendin, lokacionin e Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, nuk ekzistojnë ndotësitë afër lokacionit (fabrika, industri) që shkaktojnë koncentrim të lartë të pluhurit. Megjithatë pluhuri mund të vij nga zonat përreth, si trafiku dhe ndotja që vije nga KEK-u, edhe pse ka një distancë të konsiderueshme. Pluhuri mund të jetë problemi më i madh për ndërtimin e paneleve diellore nëse nuk selektohet prodhuesi kualitet të paneleve diellore. Çdo modul fotovoltaike duhet të ngjitet për të mos krijohen mikro poret nëpërmjet të cilave mikro pluhuri dhe lagështia mund të vijnë në kontakt me qelizat fotovoltaike dhe në këtë mënyrë shkaktojnë oksidimin dhe mosfunksionimin të moduleve fotovoltaike.

Më në fund kjo mund të shkakton reduktimin e kapacitetit dhe mosfunksionimin e plotë të centralit diellor. Prodherit të paneleve diellore me kualitetin e lartë mendojnë se ky është problemi i madh dhe çdo moduli duhet të kalon testin para që epët në funksionim.

- ***Vlerësimi i prodhimit të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe***

Nga të dhënat e përvetësuara dhe sipas kalkulimeve të bëra që që niveli i përditshëm i rrezatimit horizontal është relativisht i mirë. Ka shumë rrezatime të diellit në këtë vend dhe numri i ditëve me diell në këtë lokacion është i madh.

Ky nivel mesatar i mire i rrezatimit dhe pjerrësia optimale të paneleve diellore instalohen për shkak të ndryshimit të rrezeve të diellit. Imazhi krahason rrezet në verë dhe rrezet në vjeshtë-pranverë dhe dimër.

- ***Lidhja më infrastrukturën energjetike ekzistuese***

Investitori i Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe është pajisur me Pëlqim parimor përkatës energjetik dhe në baze të projeksionit, kjo energji e gjeneruar planifikohet të shfrytëzohet për nevojat e investitorit – Aeroportit të Prishtinës.

4.7. Alternativat e projektit

Alternativat e mëposhtme janë identifikuar dhe vlerësuar si:

Alternativa 1. Ndërtimi i Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, ndaj alternativa tjera të burimeve të energjisë.

Alternativa 2. Ndërtimi i Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, në këtë lokacion.

Alternativa 1. Nën Alternativën “1” situata ekzistuese – si burim kryesor i energjisë në Kosovë, vazhdojnë të jenë djegiet fosile (qymyri) dhe vazhdimi me këtë praktikë bie ndesh me politikat energjetike të avancuara (emitimi i CO₂) dhe politikat vendore, të cilat duhet harmonizuar dhe praktikuar burimet alternative të energjisë.

Gjithashtu, burimet (potencialet) ujore në vendin tone gjenden në kufi kritik, të mjaftueshëm, por jo shumë të volitshëm, andaj nevojitet menaxhim i mirë i ujarëve, përkatësisht mbrojtja e rezervave ujore – racionalizim në shfrytëzimin e tyre.

Alternativa 1. është pika e referimit me të cilën krahasohen kriteret e vendosura mjedisore, sociale dhe ekonomike të alternativave të projektit, andaj i jep plotësisht të drejt, pra është me i mirë - Projekti i ndërtimit të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, në këtë lokacion, ndaj alternativave të tjera.

Alternativa 2. Ndërtimi i parkut të energjisë diellore “diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, në këtë lokacion.

Lokacioni i zgjedhur është në pronësi të Aeroportit të Prishtinës nuk ka nevojë për shpronësim, nuk ka nevojë të merren toka bujqësore shtese dhe tani janë si hapësira të lira në shërbim të Aeroportit. Ky ridestitim i kësaj hapësire për panella diellorë nuk pengon veprimtarinë e aeroportit dhe aktivitetet biznesore në zonën e gjere – përreth. Zona është tipike rurale, me banime të rralla në rrethine me të lartë, me qasje në infrastrukturë dhe me efekte minimale në mjedis.

Funksionimi i Projektit të propozuar pritet të ketë ndikimet pozitive të mëposhtme:

- Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, do të përmbushë kërkesat e BE-së dhe legjislacionin e Kosovës, dhe përfundimisht do të jete një kontribut modest në prodhimin e energjisë s ripertrishme,
- Çdo sasi e energjisë shtese, si alternativë ndaj djegies së qymyrit do jetë me pake emetime të ndotjeve për mjedisin,
- Mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit publik nga emetimet e gazrave
- Përmirësimi i kushteve të jetesës së popullsisë, socio-ekonomik, vende të reja pune,
- Kontribuoni në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe në zbutjen e emetimeve të gazeve serrë.

4.8. Kosto e investimi në parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW

Limak Kosovo International Airport”J.S.C. SH.A. Prishtinë, me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë dp të investoj:

<i>Furnizimi dhe Instalimi Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW</i>					
No	Përshkrimi	Njësia	Sasi	Çmimi	Çmimi total
1	Panelet solar	copë	3366	128.70 €	433,204.20 €
2	Montimi i strukturës së konstruksionit	MW	19.48	88.44 €	172,325.34 €
3	Invertoret	copë	18	6,172.50 €	111,105.00 €
4	Kabllo DC dhe AC pjesët	LS	1	108,562.00 €	108,562.00 €
5	Stacioni i monitorimit të motit	LS	1	28,972.00 €	28,972.00 €
6	Tokëzimet mbrojtja nga rrufeja, dhe pajisjet e vëzhgimit	LS	1	€49,532.00 €	49,532.00 €
7	Linja10kV	km	1.6	€89,802.75 €	143,684.40 €
8	Realizimi i i punës	LS	1	€85,698.00 €	85,698.00 €
9	Stacioni i transformatorëve	LS	1	116,325.00 €	116,325.00 €
Total					1,249,407.94

5.VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NE MJEDIS

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e aktiviteteve të ndërtimit dhe funksionimit të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, në këtë lokacion tregojnë se deri te kvantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize gjithëpërfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre.

Ndikimet në mjedis mund të lajmërohen në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit, prandaj të gjitha ndikimet e mundshme negative në mjedis i klasifikojmë në tri perioda themelore dhe atë:

Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis duhet të bëhet:

- Për fazën e ndërtimit të parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, në këtë lokacion
- Për fazën e funksionimit të parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, në këtë lokacion
- Gjithashtu duhet parapa ndikimet e mundshme në mjedis pas përfundimit, të operimit të parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, në këtë lokacion.

5.1. Ndikimet në mjedis gjatë përgatitjeve dhe ndërtimit

Gjatë kësaj faze aktivitetet shtrihen në instalimin e pajisjeve ndërtimore dhe punëve tjera deri në përfundimin e ndërtimeve, që zakonisht kalojnë pak sipërfaqen e paraparë për instalimin e paneleve solare.

Punët kryesore të pritura të kësaj faze kanë të bëjnë me:

- Hapjen (gërmimin) e trases dhe shtrimin e rrugëve për çasje automjeteve transportuese për bartjen të pajisjeve instaluese dhe atyre ndihmëse,
- Mijjen e kanaleve të tokës (në thellësi sipas projektit teknik) për shtrimin e kablllove,
- Zhvendosjen e dheut për përshtatjen e relievit sipas nevojës,
- Vendosjen e mbajtësve të paneleve solare, bazamentin e trafostacionit.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve do të shtohet edhe lëvizja e mjeteve të ndryshme transportuese dhe përdorimi i makinerive të ndryshme për ndërtimin e strukturave të ndryshme në zonën e instalimit.

Këto aktivitete të kësaj faze do të shkaktojnë zhurmë dhe emisione të gazrave shtesë dhe varësisht nga kushtet e punës, me mundësi të emisioneve të pluhurit.

Po ashtu nuk përjashtohen edhe mundësit e rrjedhave të vajrave nga makineritë dhe gjenerimi i mbeturinave të ndryshme, nëse ato nuk menaxhohen si duhet.

5.1.1. Toka

Sipas modelit të përzgjedhur për vendosjen e paneleve solare, ndikimet në tokë do të jenë të vogla, pasi që mbajtësit e paneleve janë në formë të spiraleve dhe do të futën në thellësi deri 1.60m. Mbajtëset e paneleve janë nga çeliku i zinkuar me mundësi korrozioni zero.

Dheu i cili do të largohet në një anë gjatë vendosjes së kabllave elektrike dhe përcjelljen e tyre deri tek transformatori, do të kthehet prapë në vendin ku ka qenë.

Pra gjatë fazës së instalimeve të mbajtëseve dhe vendosjes së paneleve solar ndikimet në kualitetin e tokës do të jenë minimale.

Sasia e dheut të gërmuar nga punimet e lartcekura duhet të sigurohet që pas vendosjes së shtyllave të paneleve të mbulohet sipërfaqja e degraduar për kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme.

Sasia e dheut të mbetur të përdoret për tamponimin e rrugëve që përgatiten apo të vendoset në ato lokacione që vlerësohet se nuk ka ndikime negative në mjedis dhe në marrëveshje me strukturat udhëheqëse lokale.

5.1.2. Mbeturinat

Gjatë fazës së ndërtimit dhe instalimit të mbajtëseve dhe paneleve solar sasia e mbeturinave do të jetë e papërfillshme, do të krijohen mbeturina jo të rrezikshme nga materialet ndërtimore, ambalazhimet e ndryshme, mbeturinat komunale që janë si pasojë e punimeve të zhvilluara dhe pranisë së personelit në punishten ndërtimore.

Po ashtu gjatë ndërtimit krijohet edhe një sasi e caktuar e mbeturinave të rrezikshme ku gjatë shfrytëzimit të automjeteve transportuese dhe mekanizmave ndërtimor mund të vjen deri te derdhjet e pakontrolluara të derivateve dhe vajrave motorike në tokë e pastaj edhe në ujërat nën tokësore. Këto derdhje mund të bëhen nga mos mirëmbajtja jo e rregullt e automjeteve transportuese dhe mekanizmave ndërtimor apo nga moskujdesi i faktorit njeri.

Hedhja e mbeturinave të krijuara pa kontroll në lokacionin e punishtes do të ketë pasoja negative për mjedisin e lokacionit.

Për të gjitha llojet e mbeturinave që krijohen gjatë fazës së ndërtimit të Parku i energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, duhet të veprohet në pajtueshmëri me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071(2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina dhe të gjitha nën akteve të këtij ligji, që do të thotë se mbeturina e llojit të njëjtë.

5.1.3.Ajri

Në fazën e ndërtimit të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, deri të ndikimet në ajër mund të vjen si pasojë e le shuarjes së materieve të ndotura në ajër nga automjetet dhe mekanizmat ndërtimor që sipas Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022), konsiderohen si burime lëvizëse të emisioneve në ajër.

Në hapësirat për rreth lokacionit si ndikim në ajër konsiderohet edhe pluhuri i cili ngritët gjatë punëve ndërtimore, pastrimeve, hapjen e kanaleve, shtruarjet me dhe të platove, rrugëve etj, pastaj lëvizja e automjeteve dhe mekanizmave gjatë punës.

Emisioni i pluhurit gjatë fazës së ndërtimit ndryshon nga dita në ditë që do të thotë se varet nga intensiteti dhe lloji i punëve që zhvillohen.

Ndikimet e emisionit të pluhurit janë të kufizuara dhe vlerësohen pa pasoja afatgjate në kualitetin e ajrit.

5.1.4. Ujërat

Sipërfaqja ku do të ndërtohet Parku i energjisë me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, e ka një porozitet të theksuar dhe në rastet e reshjeve atmosferike prania e ndotjeve nga kjo sipërfaqe mund të bartet në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe të shkaktojë efekte mjedisore.

Gjatë ndërtimit të parkut të energjisë diellore nevojitet të përgatitet një sipërfaqe në formë platoje ku do të vendoset makineria punuese me të gjithë mekanizmat përcjellës në mënyrë që të pengohet ndonjë sasi e derdhjeve të vajrave apo karburanteve dhe të arrijë në rrjedhjet nën tokësore të ujërave.

Krahasuar me të gjitha llojet e burimeve të energjisë, energjia që përfitohet nga parqet diellore konsumon më së paku ujë për kW/h krahasuar me të gjitha llojet e energjisë, psh: 1kW/h nga parqet solare shpenzon rreth 0.1 lit, ndërsa nga termocentralet rreth 75 lit për kW/h. Pra në këtë aspekt, ky projekt del të jetë miqësor me mjedisin, ujërave.

Trupi ujorë përroska e ujërave sipërfaqësore gjendet në pjesën jugore të parcelles, gjendet në distance rreth 50m nga panelet diellore, dhe kjo distance duhet të respektohet, dhe përroska nuk ndikohet fare nga ky projekt.

5.1.5. Zhurma

Gjatë fazës së ndërtimit vjen deri të ngritja e përkohshme e zhurmës nga funksionimi i automjeteve transportues dhe mekanizmave ndërtimor. Si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda ndërtimore në fazën e ndërtimit të paneleve diellore, mund të vjen deri të ngritja e zhurmës

e cila në lokacionet e punës gjatë orarit të punës (8-18) mundë të jetë prej 55 - 65 dB, në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen nga Zhurma Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102 dhe Direktivën 2000/14UE për emisionin e zhurmës nga pajisjet e ndryshme që përdoren jashtë objekteve.

5.1.6.Flora dhe fauna

Gjatë fazës së ndërtimit të Parkut te energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, mundë të vjen deri te ndikimet në botën bimore dhe shtazore nga funksionimi i mekanizmave të rëndë, punëve të dheut, bota bimore do të shkatërrohet e cila do të mbillet pas përfundimit të fazës së ndërtimit, ngritjes së pluhurit, deponimi i përkohshëm i materialit ndërtimor dhe pajisjeve montazh, gjate realizimit të aktivitetit të ndërtimit.

Ndikimet negative janë me të shprehura në ato lloje të faunës që jetojnë në tokë, sepse me ndërtimin e rrugëve të kalueshme dhe sipërfaqeve për parkim dhe servisim të automjeteve dhe deponim të materialeve drejtpërdrejt ndikon në zvogëlimin e banimit të tyre.

Supozohet se nga lokacioni ku ndërtohet Parku i paneleve te energjisë diellore të gjitha ato lloje të faunës që pengohen (ndikohen) nga aktivitetet që zhvillohen në punishte do të largohen në periferi të lokacionit dhe pas përfundimit të punimeve një pjesë e tyre gjatë kërkimit të ushqimit apo lëvizjeve të tyre përsëri do të kthehet në këtë lokacion.

Pas fazës së ndërtimit nuk do të ketë rrethoja (pengesa) në punishte ashtu që të gjitha rrugët e migracionit të faunës nëpër lokacionin e Parkut te energjisë diellore do të jenë të lira.

Ndërtimi i Parkut te energjisë diellore, në hapësirat përreth nuk ka ndikim në florë dhe faunë sepse kemi të bëjmë me një energji të pastër pa emisione operacionale dhe me ndikime minimale në mjedis, pra panelet solare sjellin vetëm dobi për mjedisin.

Në territorin e ngushte ku dotë ndërtohet panelet e energjisë diellore nuk kemi ndonjë vlerë natyrore që cenohet nga aktiviteti i këtij projekti, qofte gjatë fazës së ndërtimit apo operimit të tij. Siq e kemi përshkruar te kapitulli 3.9. specifike e këtij regjioni është *Ligatina* (pran fshatit Henc, përkatësisht Radavc), ne distance nga lokacioni i projektit rreth 1.7 deri 2 km. Ne këtë Ligatine gjenden zogjtë te cilën paraqesin vlera te mbrojtura te llojit te tyre përkatësisht faunës se kësaj zone. *Duhet shtuar se ne zonën e projektit (nen menaxhim te Aeroportit) funksionon ekipi profesional "WIRDLIFE" për largimin e shpendëve nga fluturimi ne këto hapësira (për funksion të fluturimit të Aeroplanëve) dhe kjo njëkohësisht do të shërbej edhe në funksion të aktivitetit të paneleve diellore.*

5.2. Ndikimet në mjedis gjatë fazës së operimit

5.2.1. Ndikimet nga pajisjet që duhet instaluar

Këtu merren parasysh ndikimet e shkaktuara nga vetë prezenca e pajisjeve. Si rezultat i ndërtimit të bazamenteve të pajisjeve, shtrimit të rrugëve, e aktiviteteve tjera operuese - vlerësohet se sipërfaqja e ngjeshur dhe mbuluar e tokës janë te vogla (rreth 5%) krahasuar me sipërfaqet e përgjithshme të zënë nga panelet solare. Në rastin kur si bazament për panella solare përdoren shtylla të ngulitura në tokë, siç është rasti i këtij projekti, atëherë kjo sipërfaqe nuk kalon 2%. Sipërfaqja e tokës e mbuluar nga panellat solare, me përjashtim të një sipërfaqe që rreth 8%, në përgjithësi përfshihen nga rrezatimi i diellit.

Sipërfaqja pra që mund të mbetet në mënyrë të vazhdueshme nën hije, dhe që është prapë në varshmëri të lartësi së panellave, është shumë e vogël. Në skajet e panellave, si rezultat i të reshurave, mund të krijohen kanale të vogla dhe të paraqesin mundësi erozioni të tokës.

Kjo varet shumë nga rënia e terrenit dhe lloji i tokës. Në rastin konkret, kur sipërfaqja është relativisht e rrafshët dhe toka ka përbërje të konsiderueshme.

Sa i përket ndikimeve në botën shtazore nga prezenca e panellave solare, ekzistojnë vlerësime se ndikimet mund të jenë relativisht te vogla, pozitive apo negative, në varshmëri të llojeve të shtazëve. Në këtë rast toka është para këtij projekti është e kufizuar (rrëthuar) me rrethoja që pamundësojnë qasjen e kafshëve të ndryshme. Munde të kenë qasje vetëm shpendët fluturuese. Edhe pse projektet e ndërtimit gjithmonë shkaktajnë shqetësim të florës dhe faunës ekzistuese, me parqe solare është shanse për të përmirësuar kualitetin e habitatit për lloje të ndryshme të bimëve, apo edhe duke krijuar habitate të reja.

Nga ana tjetër, sipërfaqet e tokave të punuara njihen me një biodiversitet shumë më të ulët se sa sipërfaqet tjera natyrore, përjashtuar këtu vendet e thata.

5.2.2. Reflektimi i dritës

Parku i energjisë diellore përdor rrezatimin e diellit për prodhimin e energjisë, për këtë arsye transmissioni dhe absorbimi i rrezeve të diellit nga aspekti teknik është duke u forcuar dhe rrezatimi duke u reduktuar. Kjo arrihet duke instaluar shtresa antirefleksuese në qelulat solare dhe duke vendosur qelqë ballorë special. Megjithatë, vlerësohet se deri në 5% e dritës mund të reflektohet. Për shkak të këtij reflektimi, modulet solare, në një mes natyror me vegjetacion, paraqiten si objekte me të ndriçuara. Gjatë rënies së thellë të diellit (këndi i rënies nën 40%), paraqiten refleksionet në mënyrë të shtuar, mirëpo ky reflektim kryesisht shpërndahet me ndihmën e qelqeve ballorë. Në këtë rast reflektimet paraqiten në pjesën perëndimore dhe lindore të panellave. Mirëpo ky refleksion i shpërndarë vlerësohet të humb efektin vetëm në disa dm

distancë nga panellat, dhe më këtë nuk paraqet ndonjë ndikim në mirëqenien e njerëzve (në këtë rast banuesve më të afërt).

5.2.3. Pasqyrimi

Sipërfaqet pasqyruese reflektojnë objektet (fotografinë) përreth. Strukturat e habitateve të reflektuara mund të mashtrojnë shpezët (p.sh. zogjtë) duke ju krijuar imazhet e hapësirave jetësore dhe në këtë mënyrë duke joshur dhe paraqitur rrezik për ato.

Kjo para së gjithash mund të ndodhë në lokacionet me prezencë dhe mundësi të reflektimit. Mirëpo ekzistojnë edhe studime të cilat tregojnë se për një grup zoogjesh panellat solare mund të ndikojnë pozitivisht, duke ju ofruar strehim dhe biotope ushqimi kryesisht në sezonin e dimrit.

5.2.4. Peizazhi

Lokacioni ku planifikohet të ndërtohet parku i energjisë diellore është lokacion me një pejzazh homogjen në cilin nuk ka vegjetacion të ultë që mundë të pranojë një përbërje të re me ndërtimin e centralit të energjisë diellore pa ndërrime të theksuara. Në fokus do të jetë mjaftë atraktive ndërtimi i centralit të energjisë diellore mbi vegjetacionin e pjesës së rrafshet dhe uniforme.

Sipas të gjitha vlerësimeve paraprake që i përkasin ndikimeve vizuele janë pozitive për lokacionin ku planifikohet të ndërtohet centrali i energjisë diellore, një improvizim i terrenit me panele solare do të duket si në figurën 3, kapitulli 3, më lartë.

5.2.5. Fushat elektrike dhe magnetike

Si prodhues të mundshëm të rrezatimeve mund të vijnë në pyetje panellat solare, sistemi i kablllove, invertori dhe transformatori. Fusha magnetike e krijuar nga rryma njekahore (e prodhuar nga qelulat solare), janë aq të ulëta sa në një distancë prej vetëm 50 cm nga panellat janë të barabarta me fushën magnetike natyrore. Po ashtu edhe kablloprodhojnë fusha magnetike dhe elektrike të niveleve shumë të ulte dhe vetëm në zonën e ngushtë mes kablllove dhe që vlerësohen si jo problematike. Invertoret prodhojnë fusha alternative magnetike dhe forca e rrezatimit është në varshmëri të rrezatimit diellor.

Zakonisht invertoret ndërtohen në shtëpiza metali, të cilat ofrojnë një barrierë të konsiderueshme të rrezatimit. Pasi që edhe ashtu vetëm fusha alternative magnetike të vogla krijohen dhe po ashtu nuk paraqet një vend me nevojën për të qëndruar gjatë afër, atëherë edhe nuk llogaritet si me ndikim mjedisor. Dërgimi i rrymës elektrike në rrjet kalon përmes një transformatori, i cili transformon rrymën e një tensioni të ultë në atë të mesëm. Fushat maksimale të prodhuara nga këta transformator arrijnë pas pak metra vlerat e kufizuara.

5.2.6. Efektet vizuale

Edhe pse panelet solare mjedisin, në pamje të parë mund të paraqesin një prishje të kulitetit estetik, megjithatë deri më tani nuk njihen konflikte të theksuara në aspektin e prishjes së balancit natyror. Për komunitetin, falë pozicionit të lokacionit dhe madhësisë së paneleve këto panela do të jenë pak të ekspozuara ndaj tyre. Ato do të jenë të ekspozuara vetëm për ata të cilët kanë pamje nga distanca.

Sipas analizave të rezultateve të llogaritura tregon se niveli i zhurmës që lajmërohet në rrethinë si pasojë e funksionimit të paneleve solare është e papërfillshme dhe shumë më e ulët se normat maksimale të lejuara për intervalet e punës gjatë ditës (55 - 60 dB) dhe natës (40 - 50 dB).

5.2.7. Ndikimet në faunë

Fakti që toka ku do të vendosen panelat diellore është e rrethuar me rrethoja dhe menaxhohet nga Aeroporti i Prishtinës (që e ka në pronësi) e pamundëson shfrytëzimin e kësaj hapësire për kullos të bagëtive. Përndryshe do të mundej (sa u përket panellave) gjatë fazës së shfrytëzimit të paneleve solare sipërfaqet në hapësirën ku do të ndërtohen panelet solare do të mundë të shfrytëzohen për kullosa sepse panelet solare do të vendosen në shtylla dhe nuk pengon blegtorinë gjatë kullotjes. Gjatë fazës së shfrytëzimit ndikimi i paneleve solare në botën shtazore është relativisht i vogël për arsye se sipërfaqet do të jenë të lira siç janë me barë për pos ku janë të vendosura shtyllat, prandaj në këto sipërfaqe të lira, mund të zhvillohet bota shtazore, ndikime negative nga panelet solare mund të ketë në shpezët, mirëpo me kalimin e kohës edhe shpezët do të i përshtatën punës së paneleve solare. Ndikimi i paneleve solare në shpezët mund të shikohet: si ndikim direkt rreziku nga ndeshja e tyre në panelet solare dhe si ndikim indirekt nga ndikimet e zhurmës dhe ato vizuale, që mund të ndikojnë në ndërrimin e lokacionit. Në hapësirën e paneleve solare ndikimi do të jetë shumë i vogël nëse përfshihen këto kritere, të cilat do t'u përmbahet kompania.

Kriteret janë: lidhja e kabllave në tokë është më e dobishme sepse shpezët nuk mund të përdorin si vend pushim gjatë fluturimit, si në rastin nëse kabllot do të ishin të vendosura me shtylla dhe shpezët mund ta shfrytëzonin si vendpushim. Ndikim tjetër në botën e shpezëve do të ishte nëse panelet solare ndërtohen në vend shtegtimin e shpezëve. Mirëpo sa i përket shpezëve shtegtar ato fluturojnë mbi lartësitë e paneleve solare.

Siç e kemi cekur edhe më lartë, se në zonën e projektit (në menaxhim të Aeroportit) funksionin ekipi profesional "WIRDLIFE" për largimin e shpendëve nga fluturimi në këto hapësira (për funksion të fluturimit të Aeroplanëve) dhe kjo njëkohësisht do të shërbejë edhe në funksion të aktivitetit të paneleve diellore.

5.3. Ndikimet në mjedis pas ndërprerjes së shfrytëzimit

Ndikimet e mundshme pas ndërprerjes së shfrytëzimit të paneleve diellore, veprimi i çmontimit dhe largimit të pjesëve të çmontuara është relativisht i thjeshtë dhe lokacioni mundë të sanohet, të rehabilitohet duke ju kthyer tokës funksioni primar, apo të ri destinohet për qëllime tjera biznesore, sipas nevojave të pronarit dhe interesave shtetërore.

5.4. Përshkrimi i pasojave të mundshme mjedisore të projektit

Ndikimet mjedisore të mundshme nga ushtrimi i aktivitetit të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.945 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, pritet të jenë në masë që nuk tejkalojnë limitet e lejuara për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Megjithatë janë analizuar ndikimet specifike dhe në bazë të shkallës së mundshme të ndikimit, propozohen masat përkatëse për zvogëlimin e mëtejme të ndikimeve në mjedis.

5.4.1. Rreziqet e mundshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga fatkeqësitë ose katastrofat

Në rast fatkeqësisë ose katastrofave, në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë operimit të Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, është mundësia e zjarreve, shpërthimeve ekcesiale, rrjedhës së vajrave dhe karburanteve nga makineritë punuese etj. Prandaj është e nevojshme që të merren masa për parandalimin dhe sanimin e ndotjes sipas metodave adekuate ne parandalimin e këtyre rasteve dhe metodave përkatëse për sanimin dhe rehabilitimin e pasojave, nëse ndodhe diçka e tillë.

Rrezikimi i mjedisit në rastet fatkeqësive ose katastrofave mjedisore – me e mundur të vjen është nga prania dhe bartja e energjisë elektrike dhe shkaktimi i zjarreve.

Masat përgatitore dhe masat për eliminimin e pasojave (EPA) analiza e rrezikshmërisë bëhet në tri faza: identifikimi i rrezikut, analiza e pasojave dhe vlerësimi i rrezikut.

Nevojiten pajisje në dispozicion, të nevojshëm për shuarjen e zjarreve lokale eventuale dhe infrastrukturë të rregullt - qasje të lehtë të mjeteve emergjente të ndërhyrjes së shpejte, zjarrfikësit e të tjera.

5.4.2. Ndikimet e mundshme në trashëgiminë kulturore

Si pas hulumtimit të materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruar në terren, në lokacionin e ngushtë, ku gjendet Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, nuk kemi monumente të trashëgimisë kulturore, historike e natyrore të cilat eventualisht do të ndikoheshin apo rrezikoheshin nga ushtrimi i veprimtarisë së parkut të paneleve diellore.

Ne lokacionin me te largët përreth Parkut te energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë (ku ekzistojnë disa vlera historike dhe natyrore, te përshkruara si me larte) aktivitetet qe zhvillohen këtu dhe pasi te merren masat e rekomanduara nga kjo VNM dhe vet projekti teknik kryesor, nuk kanë ndikime mjedisore dhe rreziqe ekcesiale në hapësirë.

Pra gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit te parkut te energjisë diellore nuk do të ketë ndikim në trashëgiminë kulturore. Nëse eventualisht, gjatë faze se ndërtimit, punë kryerësi has në artifakte, objekte të rëndësishme arkeologjike apo objekte që përmbajnë rëndësi kulturore këshillohet që të rrethoj (siguroj) objektin dhe të njoftoj menjëherë autoritetet relevante komunale dhe qendrore.

6. MASAT PËR MBROJTJE TË MJEDISIT

Masat e mbrojtjes së mjedisit që duhet të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit te parkut të energjisë diellore, kanë për qëllim zvogëlimin e ndikimeve në mjedis për shkak të rritjes së qarkullimit, përdorimi i mekanizmave të rëndë ndërtimor, gërmimeve të dheut dhe aktivitete tjera gjatë ndërtimit. Gjatë fazës së ndërtimit duhet të ndërmerren këto masa të mbrojtjes së mjedisit.

6.1. Masat e përgjithshme gjatë ndërtimit

Gjatë ekzekutimit të punëve të dheut nevojitet të largohet shtresa sipërfaqësore dhe veçmas të deponohet dhe të mos ndotet dhe pas përfundimit të punimeve të mbulohen sipërfaqet e degraduara. Bartësi i projektit duhet të sigurojë që ekzekutimi i punimeve të bëhet me mekanizmat ndërtimor që teknikisht janë në rregull, duke iu përmbajtur dokumenteve projektuese dhe respektimi i rregullave të ndërtimit.

Të gjitha sipërfaqet që janë shfrytëzuar për nevojat e ndërtimit duhet të sanohen dhe të kthehen në gjendjen e më pashme.

Aktiviteti i zhvilluar gjatë ndërtimit duhet të ekzekutohet në atë mënyrë që të mos e pengojë qarkullimin normal të komunitetit.

Automjetet transportuese duhet të i plotësojnë kushtet sipas rregullores mbi kontrollin teknik.

6.1.1. Masat e mbrojtjes nga zhurma dhe gazrat e lëshuara

Kryesi i punëve duhet të sigurojë që ndërtimi i paneleve solare të bëhet me pajisje ndërtimore që janë teknikisht në rregull, që do të thotë se emisioni i zhurmës dhe lirimi gazeve të jetë minimal ishte i mundshëm, në kufijtë e lejueshmërisë sipas kërkesave ligjore.

Punët që bëhen nën zhurmë të lartë duhet të zhvillohen gjatë ditës pos në raste specifike kur kërkon teknologjia e punës mundë të zhvillohen edhe gjatë natës.

6.1.2. Masat e mbrojtjes së tokës dhe ujërave nën tokësore

Rezervarët ose fuqitë ku mbahen karburantet për automjetet dhe mekanizmat ndërtimor punues duhet të jenë të sigurta ose të vendosen në të dyfishta ashtu që në asnjë mënyrë të mos vjen deri derdhja e derivateve në tokë.

Servisimi i mekanizmave preferohet të bëhet në punishte apo në sipërfaqet shërbyese por duhet të bëhet në serviset e autorizuar për mekanizma.

Vaji i makinave të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë.

Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në vend punishte për shkak të avarive në makinat e punës, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet. Në punishte duhet të ketë material (pluhur druri) që në raste të derdhjeve të vajrave të ndryshme të intervenohet me njëherë për pastrim.

Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të pajimeve duhet të deponohen në enë të posaçme të cilat mbeturina do të i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

Depoja ku deponohen derivatet, vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdoruar të thuret me mur statik si dhe platoja (dysHEMEJA) të betonohet.

Të gjitha mbeturinat e krijuara duhet të mblidhen dhe të vendosen jashtë punishtes ku vendosen panelet solare kurse me ato mbeturina të veprohet sipas rregullave të ligjit të mbeturinave, të shënuar me lartë-legjislacioni.

Makinat ngarkuese dhe transportuese pas kryerjes së orarit të punës të parkohen në vendin e caktuar enkas për to. Për nevojat e personelit punues të vendosen tualete - kabinat lëvizëse.

6.1.3. Masat e përkujdesjes për materialin tepricë

Materiali nga germimi i dheut që i plotëson kushtet për përgatitjen e sipërfaqeve shërbyese dhe rrugëve kaluese duhet të shfrytëzohet për ato qëllime.

Materiali i gërmuar në vendin e gërmimit duhet të imtësohet e pastaj të transportohet në vendin ku do të shfrytëzohet.

Materiali tepricë i cili duhet të largohet nga lokacioni, duhet që në marrëveshje me komunitetin lokal të Istogut të transportohet në lokacionet ku kryen ndonjë shërbim apo vendoset diku ku nuk degradon mjedisin.

6.2. Masat e mbrojtjes së mjedisit gjatë operimit

Edhe pse ndikimet në mjedis vlerësohen të jenë minimale gjatë fazës së operimit, megjithatë shtrohet nevoja e disa nga masave të cilat evitojnë ndotjet potenciale apo minimizojnë ato.

6.2.1. Masat e mbrojtjes së llojeve bimore dhe shtazore

Ekzekutimi i punëve instaluese duhet të bëhet në atë mënyrë që pamja natyrore ekzistuese e lokacionit përreth të mos ndryshojë, ose të ndryshojnë sa më pak të jete e mundur. Të bëhet rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara dhe sipërfaqet rehabilituara të gjelbërohen duke ju përshtatur mjedisit rrethues.

Pas fazës së ndërtimit në punishte të gjitha rrugët e migracionit të faunës nëpër lokacionin e parkut të energjisë diellore do të jenë të lira. Ndërtimi i parkut të energjisë diellore, në hapësirat përreth nuk ka ndikim në florë dhe faunë sepse kemi të bëjmë me një energji të pastër me zero emisione operacionale dhe me ndikime minimale në mjedis, pra panelet solare sjellin vetëm dobi për mjedisin.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, në territorin i ngushtë, ku planifikohet të ndërtohet parkut të energjisë diellore nuk paraqet ndonjë konflikt interesi, të kontestit mjedisor.

Si e kemi theksuar edhe me lartë, specifike e këtij regjioni është *Ligatina* (në drejtim të fshatit Henc, përkatësisht Radavc), në distance nga lokacioni i projektit rreth 1.7 deri 2 km. Në këtë Ligatine gjenden zogjtë të cilën paraqesin vlera të mbrojtura të llojit të tyre përkatësisht faunës së kësaj zone.

Duhet shtuar se në zonën e projektit (nën menaxhim të Aeroportit) funksionin ekipi profesional “WIRDLIFE” për largimin e shpendëve nga fluturimi në këto hapësira (për funksion të fluturimit të Aeroplanëve) dhe kjo njëkohësisht do të shërbejë edhe në funksion të aktivitetit të paneleve diellore.

6.2.2. Masat e mbrojtjes së dheut dhe ujit

Me rastin e pastrimit eventual të panellave diellore, edhe pse supozohet se ato mund të jenë të rralla në rastet kur nuk mungojnë të reshurat e shiut, duhet pasur kujdes që të shfrytëzohet vetëm uji pa ndonjë agjentë shtesë. Nëse vjen deri te nevoja për servisimin e paneleve solare atëherë ajo duhet të bëhet në sipërfaqet shërbyese për servisim.

Të gjitha mbeturinat e krijuara gjatë servisimit, pas përfundimit të punëve duhet të largohen, mbeturinat nuk guxojnë të mbesin në lokacionin e paneleve solare.

Mbeturinat duhet të barten në lokacionet e parapara apo të lejuara në nivel komune apo në deponin regjionale.

6.2.3. Masat për menaxhimin e mbeturinave

Disa nga masat me rëndësi janë at që lidhen me menaxhimin e mbetjeve eventuale. Investitori obligohet që mbetjet dhe pjesët e ndërruara të kthehen në riciklim.

Menaxhimi i mbeturinave duhet te behet ne përputhje te plote me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina. Kompania duhet te klasifikoj dhe te dërgoj (te kontraktoj) mbeturinat ne kompani përkatëse, te specializuara për këtë qellim.

Mbeturinat të cilat gjenerohen në këtë kompleks, grumbullohen nga ana e operatorit dhe klasifikohen sipas llojit dhe përbërjes së tyre. Siç është cekur edhe më lartë mbeturinat të cilat janë të përdorshme klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të dedikuara për këto, kurse mbeturinat e papërdorshme i shiten kompanive për grumbullimin e metaleve mbeturinë, për grumbullimin e vajrave, plastikës, etj., të cilat janë të licencuara për këto veprimtari.

Mbeturinat komunale deponohen në kontejner, të cilat më pastroj barten me kamion nga kompanitë e licencuara, të cilat këto mbeturina i dërgojnë në deponitë regjionale për trajtimin e tyre të mëtejme.

Mbeturina	Emri i mbeturinës <i>Letra</i>	Shkalla e rrezikshmërisë <i>Jo të rrezikshme</i>	Lloji i deponimit <i>Kontejner</i>
13 01 13 02	Vajra dhe lubrifikante të përdorura	Të rrezikshme	Enë të posaçme
	Mbetjet nga prerja dhe presimi i metaleve	Jo të rrezikshme	Grumbullohen
15 01 01 20 01 01 20 01 08	Mbeturinat e ngurta komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

Gjate pranimi të automjeteve mbeturinë, pas fazës së çmontimit bëhet klasifikimi i pjesëve të automjeteve të cilat mund të përdoren dhe mbeturinave të papërdorshme metalike, plastike, të qelqit, mbeturinave nga goma, etj.

Mbeturinat e këtilla të papërdorshme pas kësaj seleksionohen dhe deponohen në vendet e caktuara.

Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim.

6.2.4. Masat për zbutjen e ndikimit vizual

Për zvogëlimin e ndikimit vizual, investitori do të këshillohet për mbjelljen e drunjve ne hapësirat për rreth fushës solare ne distanca qe nuk krijojnë hije për panelet solare. Drunjet (bimësia) e mbjellur duhet te jete e përshtatur me kushtet natyrore te zonës. Kjo do të ndikonte pozitivisht në pengimin e ekspozimit vizual për komunitetin e kësaj zone.

6.2.5. Masat e mbrojtjes së zogjve

Edhe pse panelet solare nuk do të kenë ndikime negative të mëdha në zogj sepse nuk do të ndërtohen në lartësi të mëdha dhe zogjet do të lëvizin mbi panelet solare, mirëpo prap se prap obligohet investitori që të respekton Direktivën për ruajtjen e zogjve të egër 79/409/EC.

Qëllimi i kësaj Direktive është që të sigurohet mbrojtje, menaxhim, dhe kontrollimin e zogjve të egër dhe foleve dhe vendbanimeve të tyre Brenda Unionit Evropian. Kjo shërben si sigurim që të gjithë zogjtë e egër të pranojnë mbrojtje të nevojshme nga asgjësimi i tyre; gjithashtu vendbanimet e tyre të mbrohen, në veçanti të sigurohet për ata të cenuar dhe migrim të zogjve; gjithashtu ndalimin e mjeteve në shkallë të lartë dhe atyre jo-selektive si dhe eksploatimin komercial të shumicës së zogjve duhet të parandalohet.

Lidhur me Traktatin, Kosova duhet të implementojë Nenin 4 (2) kur traktati hynë në fuqi. Ky nen paraqet si në vijim: Neni 4.

1. Speciet të përmendura në Shtojcën I, do të jene subjekt i masave për rruajtjen speciale lidhur me mjedisin në mënyrë që të sigurohet për të mbijetuarit e tyre dhe reproduksionin në pjesët e tyre të shpërndarjes.

- Lidhur me këtë, duhet të merret parasysh:

- a) speciet në rrezik nga zhdukja
- b) speciet të cenuar nga ndryshimet specifike në vendbanimet e tyre
- c) speciet konsiderohen të rrallë për shkak të numrit të vogël të popullatës apo shpërndarjes lokale ristriktë
- d) species tjera kërkojnë vëmendje të posaçme për arsye të natyrës specifike të mjedisit apo vendbanimit të tyre.

Rezultatet e monitorimit nga fillimi i funksionimit të paneleve solare na paraqesin një bazë themelore se a do të ketë nevojë të ndërmerren masa shtesë për mbrojtje në formë të instalimit të ndonjë pajisje të caktuar.

6.3. Masat e mbrojtjes së mjedisit pas ndërprerjes së projektit

Sipas prospekteve nga shumë prodhues të paneleve solare kemi se shfrytëzimi i tyre mund të bëhet rreth 30 deri 40 vite.

Pas kësaj periudhe varet nga investitori se a do të vazhdohet me prodhimin e energjisë solare duke bërë zëvendësimin me panele solare të rij apo panelet solare do të largohen.

Në rastet kur bëhet largimi i paneleve solare, veprimi i çmontimit dhe largimit të pjesëve të çmontuara është relativisht i thjeshtë dhe lokacioni mund të sanohet.

Në ato raste kur duhet të largohen panelet solare nevojitet të përgatitet raporti për mbrojtjen e mjedisit përmes të cilit kjo do të definohet ndikimi në mjedis dhe përshkruhen masat e nevojshme që duhet të ndërmirën.

Largimi i paneleve solare duhet të bëhet në mënyrë që të çmontohen të gjitha pajisjet mekanike dhe elektrike dhe varësisht prej gjendjes së tyre të dërgohen për riciklim në qendrat e licencuara për riciklim të metaleve apo të ripërdoren, kabllo të elektrike do të nxirren nga toka dhe pastaj do të bahet rrafshimi i hapësirave të degraduara dhe bahet mbjellja me bar apo kulturë tjetër në varshmëri nga gjendja në teren.

Pjesët nga demontimi i paneleve solare trajtohen, deponohen dhe transportohen vetëm nga operatorët dhe personat e licencuar.

Pas largimit të paneleve solare sipërfaqet e degraduara duhet të rrafshohen dhe mbulohen me një shtresë të dheut dhe të bahet mbjellja me bar e këtyre hapësirave dhe hapësirave tjera të degraduara, rikultivimi i tokave duhet të bëhet duke i përshtatur gjendjes së mjedisit rrethues.

Gjatë largimit të paneleve solare duhet të meren të gjitha masat për mbrojtjen nga ndikimet negative në mjedis të cilat janë marrë gjatë ndërtimit të paneleve solare.

7. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT

Pas përfundimit të jetë gjatësisë së Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, kjo varet nga investitori, se sa do të vazhdojë me këtë projekt, apo do të zhvillojë aktivitet tjetër, konform rregulloreve dhe legjislacionit të vendit.

Duke marrë parasysh pozitën e lokacionit i cili gjendet, si opsion tjetër ekziston që pronari të fillojë me biznes tjetër prodhues.

Pas afatit të përfundimit të këtij aktiviteti, objektet ekzistuese të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponin regjionale.

Të gjitha mbetjet e mbeturinave nga proceset për riciklimin e mbeturinave të qelqit, metalit, plastikës dhe prodhimin e produkteve të tjera - mbetjet e mbeturinave të ngurta dhe ato të inerteve

që ekzistojnë në sipërfaqet e lokacionit, si shtresa e dheut të kontaminuar pa tjetër duhet të largohen.

Të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa më kompakte, ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit.

Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues, dhe të mbjellën bimesi që kultivohen në rrethin të lokalitetit, që të kthehet në një gjendje të pranueshme mjedisore.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMI

Ndikimet direkte nga aktiviteti Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.948 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në ajër, tokë dhe ujë. Pra që konsiderohen ndër ndikimet minimale të mundshme në proceset e prodhimit të energjisë elektrike.

Këto ndikime zvogëlohen edhe më tej, minimalisht pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre dhe si të tilla mund të monitorohen, në perioda të caktuara dhe të raportohen tek institucionet – Ministria e Mjedisit.

Për këtë arsye parashihet një program monitorues për të gjitha shkarkimet.

Monitorimi i mjedisor bëhet konform legjislacionit mjedisor, në fuqi dhe të menaxhohet nga ekspertët e investitorit, duke kryer analizat në institute adekuate dhe raportohen në Ministri të Mjedisit, sipas kërkesës së tyre.

Raportimi do të kryhet nga udhëheqja e kompanisë së Parkut të energjisë diellore me fuqi 1.945 MW, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë në bazë të legjislacionit mjedisor dhe kërkesave të Ministrisë së Mjedisit.

Ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse, sipas kërkesës së tyre dhe me transparencë ndaj komuniteti lokal.

9. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE E INFORMATIVE

9.1. Përshkrimi i shkurtër i procesit

▪ Pajisjet e sistemit solar fotovoltaik

Elementet e sistemit solar fotovoltaik të kyçur në rrjet janë: moduli fotovoltaik(1), mbrojtja DC (2), invertori(3), mbrojtja AC(4), kabllimi DC (kaltër), kabllimi AC(kuqe), pika e kyçjes së objektit në rrjetin elektrik(5).

